



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE



Nr. 19865/1 Prot.

Tiranë, më 26/12/2023

Lënda: Miratim i Programit të Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë për vitin 2023.

**SHOQËRISË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SHA
DURRËS**

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, pas shqyrtimit të programit të paraqitur nga shoqëria me shkresën Nr. 67/5, datë 30.10.2023, shoqëruar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.10, datë 20.09.2022 dhe mendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 7766/2, datë 8.11.2023, miratojmë programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2023:

Nr	EMËRTIMI	Njësia e matjes	Programi i vitit 2023
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	940,290
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	1,002,420
3	Investime Gjithsej	000/lekë	3,928,350
4	Numri i punonjësve	numri mesatar	659
5	Paga mesatare	lekë	44,853
6	Fondi i pagave	000/lekë	354,700

- Investimet dhe shpenzimet miratohen në përputhje me detajimin e bërë nga shoqëria në tabelën bashkëlidhur shkresës Nr. 67/5, date 30.10.2023.
- Në lidhje me detyrimet “Kredi dhe Grande” dhe “Detyrime për hekurudhat e huaja”, merrni masa për të kryer një analizë të detajuar, ku të specifikohen saktësisht shumat e kredive aktuale, duke përfshirë normat e interesit, afatet e pagesës, dhe çdo kusht shtesë që mund të ketë ndikim në detyrimet financiare të shoqërisë.
- Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë të përgatisë informacion të detajuar lidhur me shumën e detyrimeve të prapambetura të pakërkuara, shoqëruar me dokumentacion justifikues dhe t’ja paraqesë paraprakisht Këshillit Mbikëqyrës, për të vijuar me procedurën e sistemimit të tyre në kontabilitet.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 776/2 prot.

Tiranë, më 08.11.2023

Lënda: Mbi Programin e Zhvillimit Ekonomik 2023-2025

SHOQËRISË “HEKURUDHA SHQIPTARE” SH.A. ✓

Adresa: Rruga “Egnatia” Lagje nr.3

Durrës

Për dijeni: **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Tiranë

Me shkresën nr.67/2prot., datë 29.09.2023 keni përcjellë për miratim pranë MIE “Projekt Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimin për vitin 2024-2025”, si dhe me shkresën tuaj nr.67/5prot., datë 30.10.2023, keni ridërguar programin duke saktësuar zërin e investimeve me financim të huaj.

Për sa më sipër, duke qenë se treguesit e parashikuar në program për vitin 2023-2025, paraqesin masat e marra nga shoqëria në përputhje me politikat dhe strategjitë sektoriale të miratuara në këtë fushë, në zbatim të pikës 6 të udhëzimit të MFE nr.15 datë 15.02.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, shprehemi parimisht dakord me treguesit e parashikuar në program nga “Hekurudha Shqiptare” sh.a, të miratuar me vendimin nr.10, datë 20.09.2023 të Këshillit Mbikëqyrës.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE
MINISTËR

Belinda Balluku



Nr. 67/5 Prot

Durrës, më 30/102023

Lënda : Dërgohet për miratim Projekt/Programi i zhvillimit ekonomik për vitin 2023 i ndryshuar për zërin e investimeve dhe parashikimi për vitin 2024 dhe 2025.

Drejtuar: **MINISTRISË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit
Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit
Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

MINISTRISË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Drejtoria e Administrimit të Pronës Shtetërore

TIRANË

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive tregtare me kapital shtetëror”, në vazhdim të shkresës tonë Nr. 67/2 Prot. Datë 24.09.2023, bashkëlidhur po ju ridërgojmë për miratim Projekt-Programin e zhvillimit ekonomik të Shoqërisë për vitin 2023, pasi zëri investimeve me financim të huaj për vitin 2023 është në vlerën 3.378.35 mln lekë duke e çuar vlerën e investimeve totale në 3.928.35 mln lekë, si dhe parashikimin për vitin 2024 dhe vitin 2025.

Bashkëlidhur gjeni dhe materialet shoqërues të projekt programit ekonomik.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Lutemi për veprim nga ana juaj.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Gentian LIKO



V E N D I MNr. 10 Datë 20/09/2023

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët e Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 570 datë 03.10.2018, “Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Aksionere Shtetërore”, njoftimit për mbledhje të Këshillit Mbikqyrës me rend dite “Miratimi i Projekt Programit të Zhvillimit ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimin për vitin 2024 dhe 2025”, të ndryshuar, si rezultat i rritjes së pagës minimale, miratuar me VKM Nr.113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me efekt financiar nga data 01.04.2023, diskutoi rreth saj dhe në ushtrim të përgjegjësive ligjore,:

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Projekt-Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimin për vitin 2024 dhe 2025”, të ndryshuar, të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare”, në zbatim të VKM-së Nr.113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me efekt financiar nga data 01.04.2023, me treguesit e mëposhtëm:

- Të ardhura gjithsej	940.290.000 lekë
- Shpenzime gjithsej	1.002.420.000 lekë
- Fitimi bruto	-
- Fitimi neto	-
- Humbja	62.130.000 lekë
- Fondi i pagave	354.700.000 lekë
- Sigurime shoqërore	59.230.000 lekë
- Numri mesatar i punonjësve	659
- Paga mesatare	44.853 lekë
- Subvencioni	490.000.000 lekë
- Investime gjithsej	3.928.350.000 lekë
a) Investime me financime të brendëshme	550.000.000 lekë
b) Investime me financime të huaja	3.378.350.000 lekë

2. Hekurudha Shqiptare sh.a. të paraqesë për miratim në Ministrinë Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Projekt-Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimin për vitin 2024 dhe 2025”, të ndryshuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI
ERJOLA MUKA


Brikena Nastini


Kledia Ramizi


Silvana Bajko


Kesjana Halili

12

Nr. 67/1 Prot

Durrës, më 5/5 2023

Lënda : **Ridërgohet për miratim Projekt-Programi i zhvillimit ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024 dhe 2025**

KËSHILLIT MBIKQYRËS

TIRANË.

Bashkëlidhur ju ridërgojmë për miratim Projekt-Programin e zhvillimit ekonomik të Shoqërisë, “Hekurudha Shqiptare” Sh.a Durrës për vitin 2023 dhe parashikimin për vitet 2024 dhe 2025, me të gjithë treguesit e tij, pas ndryshimit të pagës minimale nga muaj Prill 2023. Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.15 datë 02.05.2018, lutemi në veprimin tuaj të shpejtë për ti hapur rrugë miratimit të mëtejshëm të tij në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e më pas në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Gentian LIKO

DURRËS, SHQIPTARE



HEKURUDHA S

Nr. 66/1 Prot

Durrës, më 5/5 2023

V E N D I M

Nr 04 datë 5/5/2023

Administratori i Shoqërisë, mbi bazën e materialit të dërguar nga Njësia Ekonomike, për P/Projekt-programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimin për vitet 2024 dhe 2025, për Hekurudhën Shqiptare, sh.a., Durrës, pasi e vlerësoi atë, në zbatim të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregëtarët e Shoqëritë Tregëtare", "Statutit të Shoqërisë" Hekurudha Shqiptare Sh.a." ,Durrës, neni 14 i tij, si dhe Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Shoqërisë;

V E N D O S I

1. Të miratojë P/Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2023 dhe parashikimin për vitet 2024 e 2025, me të gjithë treguesit e tij, pas ndryshimit të pagës minimale nga muaj Prill 2023.
2. Njësia Ekonomike, të përgatisë materialin për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, Njësia Ekonomike.

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Gentian LIKO



RELACION

P Ë R

P/PROGRAMIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2023 DHE PARASHIKIMI PËR VITET 2024, 2025.

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare sha Durrës” është krijuar si shoqëri aksionere mbështetur në ligjin Nr.7296 datë 20/04/1995 “Për transformimin e ndërmarjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, dhe u regjistrua si e tillë në nëntor të vitit 2000, bazuar kjo dhe në Vendimin me Nr 15, datë 15.11.2000 të Ministrisë Ekonomisë dhe Privatizimit (MFE). Shoqëria është regjistruar si person juridik në Rregjistrin Tregtar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 24830 datë 18.12.2000.

Themelues i Shoqërisë është aksioneri i vetëm Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

HSH është regjistruar në organin tatimor në Durrës dhe mban NIPT-in J 61811547 D.

Veprimtaria ekonomike e Shoqërisë rregullohet sipas dispozitave ligjore, përkatësisht;

- Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare (i ndryshuar)”, Ligjit Nr. 10276 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin (i ndryshuar)”, Ligjit Nr.25/2018 dt.10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Statutit të Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare sha, legjislacionit tatimor e fiskal në fuqi si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Objekti i veprimtarisë:

Objekt i veprimtarisë së Shoqërisë është transporti hekurudhor i udhëtarëve, i mallrave dhe ngarkim/shkarkimi i tyre.

Kapitali themeltar. Kapitali themeltar (i nënshkruar) është 47.450.830 mijë lekë , i ndarë në 47.450.830 aksione me vlerë nominale 1 aksion i barabartë me 1,000 lekë.Hekurudha Shqiptare sha është shoqëri me kapital 100% shtetëror e përfaqësuar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

1.Baza e përgatitjes së projekt programi ekonomik.

Projekt Programi Ekonomik për vitin 2023 është përgatitur në bazë të parashikimeve që kanë bërë Njësitë përkatëse në treguesit e vëllimit të punës, numrin e punonjësve, fondin e pagave, të ardhurat, shpenzimet, si dhe në tregues të tjerë të vënë në bazë krahasimi me realizimin e pritshëm të vitit 2022. Për vitin 2023 hartimi i projekt programit ka hasur vështirësi përse i përket situatës së likuiditeteve dhe pagesës së detyrimeve të prapambetura.

2.Vëllimi i punës

a. Njësia Biznesit Mallit, (në transportin e mallrave).

Monitorimi/kërkimi i tregut,

Tregu i brendshëm është i kufizuar si pasojë e distancës së shkurtër të transportit, kjo edhe për faktin e ndërprerjes së lëvizjes në zonën e veriut si rezultat i mosfunksionimit të Urës së Ishmit si dhe të Stacionit Vorë nga investimi që po kryhet në këtë linjë. Tregu ndërkombëtar do të mbetet i rëndësishëm edhe për këtë vit.

Periodha më e përqëndruar është tremujori i parë i çdo viti, me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri në transport me klientët ekzistues si dhe të shihet mundësia e shtimit të volumeve të transportit nga marrëveshjet me klientë të rinj. Për këtë do të realizohen takime të vazhdueshme me kompani me peshë në treg, me qëllim:

- ruajtjen e klientëve ekzistues nëpërmjet ofrimit të zgjidhjes së problematikave (në lëvrimin në kohë të mallrave) prej vështirësive të krijuara nga tërmeti dhe pandemia.
- si dhe sigurimin e mundësive të reja për transport.

Po kështu do të mbahen kontaktet me kompani që operojnë në fushën e logjistikës brenda dhe jashtë vendit, me qëllim:

- marrjen e informacionit mbi transportin rrugor brenda dhe jashtë vendit si dhe ecurinë e transportit hekurudhor në rajon.
- sigurimin e bashkëpunimit të mundshëm, me qëllim shmangien e problematikave në përpunimin e vagonave, sidomos në rastin e përpunimit të tyre në Gjorm.

Operimi i hekurudhës me industri si ajo e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve (krom etj), apo çimentos, edhe për vitin 2023 do jetë i vështirë, pasi shoqëritë me aktivitet në tregtimin e kromit, preferojnë transportin për në portin e Durrësit me automjete, duke konsideruar dhe vështirësitë e hekurudhës për të mbërritur me linjë hekurudhore deri në vendin e nxjerrjes së mineraleve

Theksojmë se në pamundësinë e parashikimit të volumeve të tjera të transportit dhe në nivelin e ulët të parashikuar krahasimisht me vitet paraardhëse ndikojnë faktorët si mëposhtë:

- Ndërprerja e marrëdhënieve të biznesit me KURUM Sh.a duke konsideruar që në vitin 2022 transporti Kurum zuri 80% të volumit të transportit ndërkombëtar dhe 89% të transportit të brendshëm me një total rreth 64 000 ton.
- Problemet me infrastrukturën hekurudhore të HSH-së jo vetëm për shkak të mosriparimeve të dëmeve pas tërmetit por edhe të dëmeve nga zjarret të cilat i largojnë klientët, se krijojnë pasiguri në plotësimin e shërbimit.
- Mosfunksionimi i linjës Durrës-Tiranë konsideruar që në zonën Vorë-Kashar ndodhet dhe pjesa më e madhe e bizneseve me transport voluminoz si gruri, plehrat kimike, pesticidet, materialet e ndërtimit, produkte ushqimore etj.

- Konsumi i lartë i karburantit për shkak të vjetërsisë së mjeteve (lokomotivave), pasi nuk krijon mundësinë e ofrimit të tarifave konkurruese në raport me transportin automobilistik
- Flota e varfër e vagonave si në volum (numër vagonash, lloje) si dhe në raport me gjëndjen fizike të tyre, duke i bërë të papërshtatshëm për transport ndërkombëtar apo dhe të brendshëm për produkte ushqimore/bujqësore etj duke ndikuar kështu direkt në cilësinë e shërbimit dhe duke na bërë jo konkurrues në treg.
- Përveç kufizimeve në lëvizje në segmente të rëndësishme për transportin me hekurudhë, problematikë është edhe shpejtësia e ulët e lëvizjes duke ndikuar kështu direkt në shpejtësinë e ofrimit të shërbimit, pra dhe cilësinë e tij.

Gjithësesi vijojnë përpjekjet tona si njësi por edhe në bashkëpunim me partnerët tanë për krijimin e kontratave të reja sic është rasti me kompanin “16 February” për qymyrguri apo komunikimi me operatorë të tjerë për të bërë të mundur transportin e naftës drejt Ukrainës me hekurudhë dhe përpjekjet e NJBM për transport ndërkombëtar të grurit, pesticideve, etj që importohen në Shqipëri.

Treguesit,

Ton, Në vitin 2023 është parashikuar të kryhet një vëllim pune me 7,89 mijë ton. Përkundrejt programit të vitit 2022, ky vëllim pune paraqitet me një ulje prej 23,11 mijë ton (programi i vitit 2022 ishte me 31 mijë ton). Ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) të vitit 2022, vëllimi i punës paraqitet me 4.22 mijë ton më shumë, ose rreth 215,00 përqind ndaj të pritshmit (fakt) të vitit 2022 (i pritshmit (fakt) vitit 2022 është 3,67 mijë ton).

Ton/km, Në vitin 2023 është parashikuar një vëllim pune prej 670,59 mijë/ton/km. Përkundrejt programit të vitit 2022, ky vëllim pune paraqitet me një ulje prej 2029,41 mijë/ton/km (programi i vitit 2022 ishte me 2.700 mijë/ton/km). Ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) vitit 2022 parashikohet të kemi rritje me 385,19 mijë/ton/km (i pritshmit (fakt) vitit 2022 është 285,4 mijë/ton/km). Për rrjedhojë dhe të ardhurat do të kenë ulje të ndjeshme.

Të ardhurat: Në këtë projekt program të ardhurat janë paraqitur të detajuar sipas llojeve të mallrave në transportin ndërkombëtar si dhe në transportin e brendshëm. Në total të ardhurat e programuara për vitin 2023 parashikohen në vlerën 5,25 mln/lekë nga 22,70mln/lekë të programuara për vitin 2022, ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) kemi një rritje me 1,89 mln/lekë (i pritshmi (fakt) është 2,36 mln/lekë).

Në parashikimin e të ardhurave i jemi referuar sasisë së mallrave të parashikuar për transport, natyrës së mallit por edhe destinacionit përfundimtar të transportit.

Ndikimin me të madh në të ardhurat e pritëshme ka transporti ndërkombëtar që përbën dhe peshën më të madhe të volumeve të transportit të për vitin 2022 por edhe programit të vitit 2023.

Në rubrikën e të ardhurave janë përfshirë dhe të ardhura të tjera si këmbimi valutor, qera vagona, gjoba, interesa e të tjera të ardhura me vlerë 6,29 mln/lekë.

Në programin ekonomik të vitit 2023 janë parashikuar edhe të ardhura të tjera të vlerës. Kjo e ardhur për vitin 2023 është planifikuar të jetë 7,8 mln/lekë, vlerë kjo e cila vjen si diferencë e

amortizimit të rivlerësuar me amortizimin e parivlerësuar të aseteve, që perfaqësojnë të ardhura të pashpërndara dhe kanë ndikim në fitimin e mbartur. Përkundrajt programit të vitit 2022, të ardhurat në total për vitin 2023 paraqiten me 13.56 mln/lekë më pak, ose 58,78 përqind të programit vitit 2022. Ndërsa ndaj realizimit të pritshëm (fakt) vitit 2022, parashikohet me 76,63 mln/lekë më pakë, ose 20,15 përqind e realizimit të pritshëm (fakt) vitit 2022. Në këtë diferencë ka ndikuar zëri i të ardhurave të vlerës me 64,01 mln/lekë, kjo si rezultat i daljes jashtë përdorimi të aseteve.

Në parashikimin e të ardhurave i jemi referuar sasisë së mallrave të parashikuar për transport, natyrës së mallit por edhe destinacionit përfundimtar të transportit. Të ardhurat llogariten bazuar në librin tarifor të publikuar në APP ku tarifata përcaktohen në bazë të peshës së ngarkuar për vagon, natyrës së mallit dhe distancës së përshkruar. Të ardhurat e planifikuara për vitin 2023 lidhen vetëm me volumet e parashikuara për transport ndërkombëtar të vajit ushqimor si i vetmi transport i konfirmuar si parashikim nga klienti përkatës (DEVI 20 GRUP).

Në programin ekonomik të vitit 2023 janë parashikuar edhe të ardhura të tjera të vlerës, ku kjo e ardhur për vitin 2023 është planifikuar të jetë 7.80 mln/lekë, vlerë kjo e cila vjen si diferencë e amortizimit të aseteve me vlerë të rivlerësuar me amortizimin e aseteve me vlerë të parivlerësuar, mbështetur kjo në SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale”.

Në zërin “Të ardhura të tjera” janë përfshirë, të ardhura nga zhdëmtimet, nga kurset e këmbimit të euros, si dhe të ardhurat që parashikohen nga dhënia me qera e vagoneve të mallit, bazuar në kontratën e qera-dhënies me Nr.735/5 datë 22.09.2022 ku të ardhurat vjetore janë 45 000 Euro, ose 5,29 mln/lekë.

Shpenzimet:

-**Paga**, Sipas strukturës së miratuar për vitin 2023 numri i punonjësve të programuar është 91 punonjës.

Nisur nga realizimi i pritshëm i treguesve të transportit 2022, planifikimit të treguesve transportit për vitin 2023, si dhe niveli i pagës minimale aktualishtë (pra nga muaj prill), është planifikuar edhe fondi i pagave për këto 91 punonjës.

Në total fondi pagave i programuar për vitin 2023 për 91 punonjës, pra sipas kësaj strukture vlera e fondit të pagave është 48,30 mln/lekë, nga 110 punonjës me vlerë 49,99 mln/lekë në vitin 2022, vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 41,88 mln/lekë.

-**Sigurime shoqërore**, Referuar fondit të pagave të programuara shpenzimet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 8,07 mln/lekë, nga 8,35 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 7,04 mln/lekë).

-**Trajtime e shërbime personal**, është planifikuar shpërblim pensioni për 4 punonjës, bazuar në kontratën kolektive të punës në shumën 0,28 mln/lekë referuar këtu pagës minimale.

-**Udhëtim e dieta**, Për vitin 2023 janë parashikuar 1.9 mln/lekë. Në planifikimin e këtij zëri janë patur parasysh volumet e pritshme të punës të parashikuar për vitin 2023. Në parashikimin e këtij

shpënzimi është pasur parasysh fakti që transporti është kryesisht ndërkombëtar, dhe i jemi referuar urdhërave mbi trajtimin e personelit të levizjes me dietë.

-Materiale, Janë parashikuar 0,60 mln/lekë, blerje të ndryshme materiale konsumi, nga më të nevojshmet si; fikse zjarri për lokomotivat, kancelari, shtypshkrime, lecka pastrimi, bojë për lyerjen e lokomotivave dhe vagonave në qarkullim, etj, ndërsa në vitin 2022 ky zë i shpenzimeve ishte 0,79 mln/lekë.

-Lëndë djegëse, Janë parashikuar 3,5 mln/lekë (në vitin 2022 ky zë i shpenzimeve ishte 10,25 mln/lekë), ku në këtë zë përfshihen shpenzimet për gazoil dhe lubrifikant për lokomotivat dhe autoveturën.

Ky zë i shpenzimeve përfshin shpenzimet e karburantit për transport, shpenzimet e karburantit dhe lubrifikantëve të tjerë për efekt riparimi dhe manovrave përkatëse si dhe shpenzimet e karburantit për lëvizjen e personelit të Rajonit Veriut drejt Stacionit të përbashkët Tuz.

Konsideruar që:

- Konsumi i karburantit për transport malli dhe të lëvizjes së personelit për në Tuz është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me volumet dhe është parashikuar duke pasur parasysh volumin e punës ton/km të planifikuar për vitin 2023 që parashikohet të jetë 670,59 mijë/ton/km bazuar në ton/km e pritsëm për vitin 2022 në sasinë 424 mijë/ton/km.
- Sasitë për karburant dhe lubrifikant të nevojshëm për riparimin e planifikuar të mjeteve, mbeten në të njëjtat nivele meqenëse numri i mjeteve të parashikuara për riparim është thujtë i njëjtë me vitin 2022.
- Çmimi i karburanteve ka levizur nga 146 lekë/litër në mesatarisht 180-200 lekë/litër

Vlera e parashikuar për koston e karburantit për vitin 2023 siç përmendëm më lartë është 3,5 mln lekë.

-Kosto e orë-qëndrimit vagonave të huaj në territorin e HSH-së, Duke u nisur nga volumet e punës të pritshme për vitin 2023 për transportin ndërkombëtar të mallrave, parashikohen orë-qëndrime për vagonat e huaj në territorin e HSH e shprehur në euro gjithsej rreth 11.702.88 Euro, ose 1,38mln/lekë.NJBM-ja do të ketë vëmendjen e duhur për reduktimin e kohës së qëndrimit të vagonave të huaj duke u përpjekur për të përmirësuar kohën e përpunimit të mallrave dhe në bashkëpunim me Infrastrukturën Hekurudhore për të parë mundësinë e rritjes së shpejtësisë së lëvizjes .

-Shpenzime telefonike,Për vitin 2023 parashikojmë shpenzime telefonike në vlerën 0,20 mln/lekë, kjo nga nevoja e përdorimit të telefonisë fikse në N/Njësinë e Veriut, Zyrës së Marketingut dhe dispecerisë.

Për vitin 2022 janë reduktuar shpenzimet për këtë zë por nuk mund të ndërpriten sidomos telefoni i Zyrës së Marketingut dhe i N/Njësisë Rajonale të Veriut si dhe rrjetin e internetit për rëndësinë e komunikimit në kordinimin dhe mbarëvajtjen e punës.

-Zëri i Shpenzimeve të tjera, Janë parashikuar 3,02 mln/lekë, përfshin shpenzime qera për ambientet në stacionin e përbashkët kufitar në Tuz 0,13 mln/lekë, diferencat nga këmbimet valutore 1.5 mln/lekë, blerje gaz për ngrohje për zonën e Veriut, mirëmbajtje dhe riparime të vogla të Automjetit në pronësi të NJBM, dhe mjeteve lëvizëse 0.17 mln/lekë, sigurim i automjetit, taksa vjetore 0.1 mln/lekë dhe shpenzime të tjera 1,12 mln/lekë.

-Amortizimi, Vlera e amortizimit të aseteve për vitin 2023 është parashikuar të jetë 14 mln/lekë kjo, vlerë është përlogaritur po me normat e amortizimit të përdorura në vitin 2022.

Për autoveturen me 6%, lokomotivat me 3.3%, vagona malli me 5%, inventar ekonomik me 3% dhe pajisje kompjuterike me 15% (në të gjitha rastet % kundrejt vlerës së mbetur). Normat e amortizimit të aseteve që ng aviti 2006 janë llogaritur mbi bazën e normave teknike të përshtatshme për sistemin hekurudhor që janë miratuar nga ish MZHETS (sot MFE) me vendim të Këshillit Mbikqyrës Nr.24 dt.18.12.2006.

-Shpenzime financiare, (+ interesa), janë parashikuar 5,12 mln/lekë, kjo për faktin se hekurudhat e huaja po kërkojnë të aplikojnë interesa nga mosshlyerja e detyrimeve të orë-qëndrimeve të vagonave ndër vite, si dh shpenzime të tjera financiare, si komisione bankare e të tjera shpenzime.

-Shpenzime administrimi DPH, për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 24,52 mln/lekë, nga 20,20 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 20,12 mln/lekë).

-Taksa e hyrjes në Infrastrukturën Hekurudhore, Kjo taksë është parashikuar të jetë 1,13 mln/lekë në vitin 2023, nga 16,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,62 mln/lekë). Për këtë është bërë përlogaritje bazuar në tren/ km e planifikuar për vitin 2023 të jenë 3.992 (1146 tren/km plot dhe 1146 tren/km bosh dhe 1700 tren tek) janë përdorur tarifatat në fuqi. Vlera totale e taksës hyrëse në infrastrukturën hekurudhore për vitin 2023 që është parashikuar 1,13 mln/lekë bazohet në projekt kontratën me Nj.BMIH Nr 1237/4 datë 21/09/2022.

-Shpenzime të brendshme nga NJSHML, Shpenzimet e brendshme nga NJSHML për vitin 2023 janë parashikuar të jenë 28.3 mln/lekë, nga 48,18 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 29,34 mln/lekë). Në parashikim e këtij zëri është patur parasysh nevoja për riparime dhe shërbime të mjeteve lëvizëse duke u nisur nga volumet e punës të pritshme që do të kryhen nga mjetet e transportit të NJBM si dhe mbajtjen në gadishmëri të mjeteve për ndonjë transport të mundshëm jashtë planifikimit. Në parashikimin e shpenzimeve për riparime NJBM në mungesë të specialistit teknik kemi bashkëpunuar me specialistët e NJSHML.

Vlera totale e riparimeve të vagonave dhe lokomotivave të NJMB-së për vitin 2023, që është në vlerën 28.3 mln/lekë, është bazuar në shkresën nr.202 datë 28/09/2022 të NJSHML.

Rezultati financiar duke u bazuar në planifikimin aktual të programit të zhvillimit ekonomik, përfshirë këtu edhe shpenzimet e brendshme mes njësave, parashikohet të rezultoj me humbje-120,98 mln/lekë për vitin 2023, nga - 158,87 mln/lekë që ishte programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi i vitit 2022 (fakt) është mbyllur me - 137,31 mln/lekë.

b. Njësia Biznesit Udhëtar, (në transporti e udhëtarëve).

Treguesit,

Udhëtarë, Në vitin 2023 është parashikuar të kryhet një vëllim pune me 21,5 mijë udhëtarë, nga 10,60 mijë udhëtarë që është mbyllur viti 2022, pra me një rritje prej 9,5 mijë udhëtarë. Në krahasim me planin e vitit 2022 kemi planifikuar po të njëjtët tregues.

Udhëtarë/km, është parashikuar një vëllim pune prej 780 mijë/udh/km, po nga 780 mijë/udh/km të programuar në vitin 2022, ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) të vitit 2022 kemi programuar rritje me 343 mijë/udh/km. Për pasojë dhe të ardhurat janë parashikuar me rritje në krahasim me faktin e vitit 2022. Programi i vëllimit të punës dhe të ardhurave në transportin e udhëtarëve edhe për vitin 2023 do të mbeten të ulta, me ndikim mjaft të vogël në sasinë e të ardhurave të Shoqërisë.

Transporti hekurudhor i udhëtarëve aktualisht ofron shpejtësi të ulët dhe për rrjedhojë kohë më të gjatë udhëtimi në krahasim me transportin automobilistik, që ka pasur përmirësime të vazhdueshme. Shkaku kryesor, që e bën jo konkurrues në treg transportin udhëtar është mungesa shumë vjeçare e investimeve të domosdoshme në infrastrukturën hekurudhore përfshirë dëmtimet edhe nga tërmeti i Nëntorit 2019, si dhe ndërprerja e lëvizjes në segmentin Durrës-Tiranë për shkak të investimit që po kryhet.

Në këto kushte transporti hekurudhor i udhëtarëve nga viti në vit ka pësuar ulje të vazhdueshme të numrit të udhëtarëve dhe për pasojë rënie të ndjeshme të të ardhurave.

Shkak tjetër është dhe pandemia globale, e cila detyron pasagjerët të shmangin në maksimum përdorimin e transportit publik. Për tërheqjen e trenave udhëtarë shërbejnë lokomotiva të të njëjtit tip si në transportin e mallrave, CKD 669 me fuqi 1350 H/P, por që në kushtet kur këto trena janë të formuar vetëm me dy vagonë, nuk janë aspak efektive, si në drejtim të konsumit të madh të lëndës djegëse ashtu dhe në shpenzimet për riparimin dhe shërbimin e tyre.

Zëvendësimi në të ardhmen i këtyre lokomotiva me Njësi Motorrike Diezel (DMU), apo me lokomotiva me alternativë tjetër tërheqje (elektrike), do të mundësojnë uljen e shpenzimeve për karburant dhe mirëmbajtjen e tyre. Transporti hekurudhor i udhëtarëve, mendojmë se do të njohë rritje me rikostruksionin e linjave hekurudhore, e cila ka filluar më së pari me linjën Durrës-Tiranë, si dhe ndërtimi i linjës së re për lidhjen me hekurudhë të Aeroportit të Rinasit.

Të ardhurat. Të ardhura për vitin 2023 janë programuar 1,20 mil/lekë nga 1,20 mil/lekë që janë programuar për vitin 2022, ndërsa ndaj të pritshmit të vitit 2022 parashikohet një rritje prej 0,53 mil/lekë, viti 2022 është mbyllur me 1.13 mil/lekë). Në rubrikën e të ardhurave janë përfshirë dhe të ardhura të tjera si gjoba, interesa e të tjera të ardhura me vlerë 1,00 mil/lekë. Nënvizojmë se në p-programin e Nj.B.U nuk është përfshirë vlera e subvencionit me 490 mil/lekë, sepse është përfshirë tek HSH Qendër.

Në programin ekonomik të vitit 2023 janë parashikuar edhe të ardhura të tjera të vlerës. Kjo e ardhur për vitin 2023 është planifikuar me 4 mln/lekë, vlerë kjo e cila vjen si diferencë e amortizimit të rivlerësuar me amortizimin e parivlerësuar të aseteve që përfaqësojnë të ardhura të

pashpërndara dhe kanë ndikim në fitimin e mbartur, mbështetur kjo në SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale”.

Përkundrejt programit të vitit 2022, të ardhurat paraqiten me 1.60 mln/lekë më pak, ndërsa ndaj realizimit të vitit 2022 përsëri parashikohet po me ulje, 0.37 mln/lekë më pak.

Shpenzimet:

-Paga, Numri mesatar i punonjësve në fakt për vitin 2022 është 150 punonjës, ndërsa sipas strukturës së miratuar për vitin 2022 numri i punonjësve është 168.

Për vitin 2023 sipas strukturës së miratuar numri i punonjësve është parashikuar me 96 punonjës, kjo si rezultat i reduktimit në tremujorin e katërt të vitit 2022. Pra në total numri mesatar i punonjësve për vitin 2023 është parashikuar 96 punonjës si dhe referuar nivelit pagës minimale aktualishtë (pra nga muaj prill) fondi i pagave është parashikuar të jetë 51,15 mln/lekë, nga 62,21 mln/lekë e programuar në vitin 2022, (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 57,35).

-Sigurime shoqërore, Referuar fondit të pagave të programuara shpenzimet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 8,54 mln/lekë, nga 10,39 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 9,62 mln/lekë).

-Materiale, Janë parashikuar blerje të ndryshme materiale kryesisht më të nevojshmet si: fiksë zjarri për lokomotivat (mbushje), detergjentë për pastrimin e vagonave, kancelari, shtypshkrime, lecka pastrimi e të tjera materjale konsumi me vlerë 0,10 mln/lekë, nga 3 mln/lekë të programuara në vitin 2022, ndërsa i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,07 mln/lekë.

-Lëndë djegëse, ku përfshihen; gazoil dhe vajra për lokomotivat dhe autoveturën, për vitin 2023 janë programuar 6,80 mln/lekë nga 14,64 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 6,60 mln/lekë). Ky zë i shpenzimeve është parashikuar duke pasur parasysh volumin e punës në udhëtar/km i pritshëm (fakt) për vitin 2022 që është mbyllur me 437 mijë udhëtar/km dhe çmimit mesatar të blerjes së gazoilit për vitin 2023, referuar këtu luhatjeve të tijë.

-Udhëtim e dieta. Për vitin 2023 janë parashikuar 0,54 mln/lekë nga 3.00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi parashikohet me 0,54 mln/lekë). Në planifikimin e këtij zëri është patur parasysh volumet e pritshme të punës të parashikuar për vitin 2023, pra të lëvizjes së personelit për trenat e udhëtarit.

-Shpenzime telefonike. Për vitin 2023 janë parashikuar 0,10 mln/lekë nga 0.20 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,04 mln/lekë). Shpenzime telefonike në vlerën 0,10 mln/lekë, në pjesën më të madhe janë për shkak të përdorimit të telefonisë fikse ndërmjet N/Njësive, zyrës së marketingut dhe dispeçerisë që komunikojnë ndërmjet tyre.

-Zëri i shpenzimeve të tjera, Për vitin 2023 janë programuar 0,28 mln/lekë nga 1.40 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,01 mln/lekë). Në këtë vlerë janë përfshirë vlera e kostos së biletave me 0,02 mln/lekë, konsumi i veshmbathjeve dhe inventarit të imët me 0,02 mln/lekë dhe të tjera shpenzime me vlerë 0,24 mln/lekë.

-Amortizimi. Vlera e amortizimit për vitin 2023 është parashikuar të jetë 17,00 mln/lekë nga po 17,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 9,45 mln/lekë), vlerë kjo e cila përbën amortizimin e asetëve të llogaritur po me ato norma amortizimi të përdorura për vitin 2022.

Normat e amortizimit; për lokomotivat dhe vagona udhëtarë si dhe inventar ekonomik janë llogaritur sipas normave të miratuara, në të gjitha rastet % kundrejt vlerës së mbetur. Normat e amortizimit të asetëve që nga viti 2006 janë llogaritur mbi bazën e normave teknike të “përshtatshme për sistemi nhekurudhor»” që janë miratuar ng aish MZHETS (sot MFE) me Vendim të Këshillit Mbikqyrës Nr.24 dt.18.12.2006.

- Zëri i shpenzimeve financiare, Për vitin 2023 janë programuar 0,04mln/lekë nga 0.10 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,02 mln/lekë), ku në këtë vlerë janë përfshirë shpenzime për komisione bankare dhe interesa.

Krahas këtyre shpenzimeve direkte Nj.B.U ka edhe shpenzime që i përkasin marrëdhënjeve të brendshme me njësit e tjera të HSH-së, përkatësisht:

- Shpenzime administrimi me HSH Qendër, shpenzimet për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 36,78 mln/lekë, nga 30,30 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 30,19 mln/lekë).

-Taksa hyrjes në Infrastrukturën Hekurudhore,(me Nj.BMIH), për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 28,22 mln/lekë, nga 28,16 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 12,05 mln/lekë). Për këtë është bërë përlllogaritje bazuar në volumet e punës të pritshme për vitin 2023.

-Shpenzime të brendshme nga, NJSHML. Shpenzimet e brendshme nga NJSHML për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 22,70 mln/lekë, nga 44,38 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 43,50 mln/lekë). Në parashikim e këtij zëri është patur parasysh nevoja për riparime dhe shërbime sipas relacionit të sektorit teknik duke u nisur nga volumet e pritshme që do të kryhen nga mjetet e transportit të NJBU.

Rezultati financiar, duke u bazuar në planifikimin aktual të programit të zhvillimit ekonomik, përfshirë këtu edhe shpenzimet e brendshme mes njërive, parashikohet me humbje - 166,06 mln/lekë për vitin 2023, nga + 185,22 mln/lekë që ishte programuar në vitin 2022 (bashkë me subvencionin), ndërsa i pritshmi (fakt) është mbyllur me +203,04 mln/lekë.

Nënvizojmë se në humbje e vitit 2023 ka ndikuar heqja e subvencionit me vlerë 490 mln/lekë vlerë kjo e cili është pasqyruar në p-programin e HSH Qendër, si dhe ulja e ndjeshme e taksës së infrastrukturës dhe e riparimit mjeteve lëvizëse, kjo nga ndikimi i ndërprerjes së lëvizjes si rezultat i investimit që po bëhet në linjën hekurudhore Durrës-Tiranë.

c.Njësia Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore, (infrastruktura hekurudhore).

Të ardhurat. Të ardhura nga aktiviteti kryesor për vitin 2023 janë programuar 33,35 mil/lekë nga 71,00 mil/lekë që janë parashikuar në vitin 2022, ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) të vitit 2022 është mbyllur me ulje prej 2049,71 mil/lekë (i pritshmi (fakt) për vitin 2022 është 2381,41 mil/lekë).

Ndikim në këtë diferencë të të ardhurave kanë dhënë dalja jashtë përdorimi e aseteve (të ardhura të vlerës (mbartura) me 1918,85 mil/lekë dhe të ardhura nga materialet e bëra hyrje me 164,11 mil/lekë). Në rubrikën e të ardhurave janë përfshirë; të ardhurat nga materialet e investimeve me fonde buxhetore me vlerë 25 mil/lekë, nga 7,42 mil/lekë i pritshmi (fakt) i vitit 2022, ose me një rritje prej 17,58 mil/lekë, për të cilën nënvizojmë se sipas standarteve të kontabilitetit kjo vlerë raportohet edhe si shpenzim.

Materialet që parashikohen për vitin 2023 me vlerë rreth 25,00 mil/lekë janë të bazuara nga gjëndja në depo në fund të vitit 2022 dhe blerjet e reja që do të bëhen në vitin 2023. Të ardhurat nga qerat e ambjenteve janë programuar 3,35 mil/lekë, nga 3,36 mil/lekë i pritshmi (fakt) i vitit 2022, ose me një ulje prej 0,01 mil/lekë.

Të ardhura të tjera si punime për të tretë, shitje traversash të hequra nga linja, gjoba, interesa e të tjera të ardhura me vlerë 5 mil/lekë, nga 2,50 mil/lekë i pritshmi (fakt) i vitit 2022, ose me një rritje prej 2,50 mil/lekë.

Në programin ekonomik të vitit 2023 janë parashikuar edhe të ardhura të tjera të vlerës. Kjo e ardhur për vitin 2023 është planifikuar të jetë 269 mln/lekë nga 270 mil/lekë i programuar për vitin 2022, vlerë kjo e cila vjen si diferencë e amortizimit të rivlerësuar me amortizimin e parivlerësuar të aseteve që përfaqësojnë të ardhura të pashpërndara dhe kanë ndikim në fitimin e mbartur, mbështetur kjo në SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale”.

Në këtë njësi krahas këtyre të ardhurave janë programuar edhe të ardhura të brendshme nëpërmjet marrdhënjeve mes njërive, me vlerë 29,35 mln/lekë, përkatësisht me Nj.B.Udhëtarë 28,22 mln/lekë dhe me Nj.B.Mallit me 1.13 mln/lekë, nga 44,16 mln/lekë e programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi (fakt) i vitit 2022 është mbyllet me 12,67 mil/lekë, përkatësisht, me Nj.B.Udhëtarë 12,05 mln/lekë dhe me Nj.B.Mallit me 0.62 mln/lekë). Nënvizojmë se këto vlera janë bazuar në akt-marrveshje që njësitë e biznesit kanë lidhur me Nj.BMIH.

Shpenzimet:

-Paga, Për vitin 2022 sipas strukturës së miratuar numri i punonjësve është parashikuar me 510 punonjës, kjo si rezultat i reduktimit të numrit të punonjësve në tremujorin e katër të vitit 2022. Numri i punonjësve për vitin 2023 ashtu si dhe në tremujorin e katër të vitit 2022 do të jetë 349 punonjës. Pra në total numri i punonjësve mesatar për vitin 2023 është parashikuar të jetë 349 punonjës dhe fondi i pagave referuar strukturës dhe nivelit pagës aktuale, referuar nivelit pagës

minimale aktualishtë (pra nga muaj prill) është parashikuar të jetë 173,05 mln/lekë, nga 209,28 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 182,50 mln/lekë).

-Sigurime shoqërore, Referuar fondit të pagave të programuara shpenzimet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 28,90 mln/lekë, nga 34,95 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 30,82 mln/lekë).

-Materiale, Janë parashikuar materiale nga gjendja në depo dhe blerje të reja të nevojshme si: materiale për linjen hekurudhore dhe të tjera materiale konsumi me vlerë 5,00 mln/lekë, nga 5,00 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 0,54 mln/lekë).

Gjithashtu siç përmendëm më lart në rubrikën të ardhurave nga materialet e investimeve buxhetore janë planifikuar shpenzime për materiale me fonde investimesh në vlerë 25,00 mln/lekë nga 63,00 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 7,42 mln/lekë).

-Lëndë djegëse, ku përfshihen: gazoil dhe vajra për automjetet e njësisë janë programuar 2,52 mln/lekë nga 2,50 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 1,05 mln/lekë). Ky zë i shpenzimeve është parashikuar duke pasur parasysh volumin e punës së automjeteve dhe çmimit mesatar të blerjes së gazoilit për vitin 2023, referuar këtu luhatjeve të tijë.

-Energji dhe ujë, Për vitin 2023 janë parashikuar 13,00 mln/lekë, nga 11,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 5,61 mln/lekë). Shpenzime këto që do të nevojiten për ambjentet që disponon kjo njësi, si magazina ,zyra ,godinat e rojeve të kalesave etj. Duke u nisur nga fakti që Nj.BMIH disponon shumë borxhe ndaj OSHEE në vlerën prej 13 mln/lekë është parashikuar dhe likujdim nga pjesa e interesave.

-Udhëtim e dieta Për vitin 2023 janë parashikuar 2.00 mln/lekë, nga 3,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,64 mln/lekë). Në planifikimin e këtij zëri është patur parasysh volumet e pritshme të punës të parashikuar për vitin 2023, pra të levizjes së personelit për nevojat e aktivitetit nëpër linjat hekurudhore dhe stacionet që disponon kjo njësi.

-Shpenzime telefonike Për vitin 2023 janë parashikuar shpenzime telefonike në vlerën 1,00 mln/lekë, nga 1,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,04 mln/lekë). Shpenzime këto që në pjesën më të madhe janë për shkak të përdorimit të telefonisë fikse ndërmjet N/Njësive, zyrës së marketingut dhe dispečerisë që komunikojnë ndërmjet tyre.

-Amortizimi. Vlera e amortizimit për vitin 2023 është parashikuar të jetë 350 mln/lekë, nga 355 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 283,58 mln/lekë), vlerë kjo e cila përbën amortizimin e aseteve të llogaritur po me ato norma amortizimi të përdorura për vitin 2022.

Normat e amortizimit; për asetet që disponon njësi janë llogaritur sipas normave të miratuara, në të gjitha rastet % kundrejt vlerës së mbetur. Normat e amortizimit të aseteve që ng aviti 2006 janë llogaritur mbi bazën e normave teknike » të përshtatshme për sistemin hekurudhor» që janë miratuar nga ish MZHETS (sot MFE) me vendim të Këshillit Mbikqyrës Nr.24 dt.18.12.2006.

-Zëri i shpenzimeve të tjera Për vitin 2023 janë programuar 8,92 mln/lekë, nga 9,90 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 9,50 mln/lekë), ku në këtë vlerë janë përfshirë; vlera e konsumit të veshmbathjeve dhe inventarit të imët me 1,00 mln/lekë, tatime e taksa automjetesh me 2,00 mln/lekë, dhe të tjera shpenzime me vlerë 5,92 mln/lekë, penalitete e gjoba, interesa, dalje jashtë përdorimi asete, etj.

-Zëri i shpenzimeve financiare, janë programuar për vitin 2023 1,00mln/lekë, nga 1,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,01 mln/lekë), ku në këtë vlerë janë përfshirë shpenzime për komisione bankare dhe interesa.

Krahas këtyre shpenzimeve direkte Nj.BMIH ka edhe shpenzime që i përkasin marrdhënjeve të brendshme me HSH qendër **Shpenzime administrimi me HSH Qendër,** për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 36,78 mln/lekë nga 30,30 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 30,19 mln/lekë).

Rezultati financiar, duke u bazuar në planifikimin aktual të programit të zhvillimit ekonomik, përfshirë këtu edhe të ardhurat dhe shpenzimet e brendshme mes njësave, parashikohet me humbje - 316,47 mln/lekë për vitin 2023, nga - 340,77 mln/lekë që ishte programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi (fakt) është mbyllur me - 268,35 mln/lekë.

d.Njësia Shërbimit Mjeteve lëvizëse, (riparimi i mjeteve hekurudhore).

Të ardhurat. Të ardhura nga aktiviteti kryesor për vitin 2023 janë programuar 34,00 mil/lekë nga 27,50 mil/lekë që janë parashikuar në vitin 2022, ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) parashikohet një rritje prej 10,96 mil/lekë (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 23,04 mil/lekë).

Në rubrikën e të ardhurave janë përfshirë; të ardhurat nga materialet e investimeve me fonde buxhetore me vlerë 28 mil/lekë, nga 6,43 mil/lekë fakti i vitit 2022, ose me një rritje prej 21,57 mil/lekë, për të cilën nënvizojmë se sipas standarteve të kontabilitetit kjo vlerë raportohet edhe si shpenzim. Materialet që parashikohen për vitin 2023 me vlerë rreth 28,00 mil/lekë janë të bazuara nga gjendja në depo në fund të vitit 2022 dhe blerjet e reja që do të bëhen në vitin 2023. Të ardhura të tjera si punime për të tretë, prodhim në proces, gjoba, interesa e të tjera të ardhura janë programuar 6,00 mil/lekë, nga 7,50 mil/lekë e programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi i vitit 2022 është mbyllur me 16,61 mil/lekë, ku ndikim këtu ka dhënë dalja jashtë përdorimi e aseteve.

Në programin ekonomik të vitit 2023 janë parashikuar edhe të ardhura të tjera të vlerës. Kjo e ardhur për vitin 2023 është planifikuar të jetë 2,00 mln/lekë nga 2,00 mil/lekë e programuar dhe i pritshmi (fakt) i vitit 2022 është 1,86 mil/lekë, vlerë kjo e cila vjen si diferencë e amortizimit të rivlerësuar me amortizimin e parivlerësuar të aseteve që përfaqësojnë të ardhura të mbarturra dhe kanë ndikim në fitimin e mbartur, mbështetur kjo në SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale”.

Në këtë njësi krahas këtyre të ardhurave janë programuar edhe të ardhura të brendshme nëpërmjet marrdhënjeve mes njësave, me vlerë 51,00 mln/lekë, përkatësisht me Nj.B.Udhëtarë 22,70 mln/lekë dhe me Nj.B.Mallit me 28,30 mln/lekë, nga 92,56 mln/lekë e programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi (fakt) i vitit 2022 është mbyllet me 72,84 mil/lekë, përkatësisht, me Nj.B.Udhëtarë

43,50 mln/lekë dhe me Nj.B.Mallit me 29.34 mln/lekë).Nënvizojmë se këto vlera janë bazuar në akt-marrëveshje që njesitë e biznesit kanë lidhur me Nj.BMIH.

Shpenzimet:

-Paga, Për vitin 2022 sipas strukturës së miratuar numri i punonjësve është parashikuar me 88 punonjës, kjo si rezultat i reduktimit të numrit të punonjësve në tremujorin e katër të vitit 2022.

Numëri i punonjësve për vitin 2023 ashtu si dhe në tremujorin e katërt të vitit 2022 do të jetë 62 punonjës.Pra në total numri i punonjësve mesatar për vitin 2023 është parashikuar të jetë 62 punonjës dhe fondi i pagave referuar strukturës dhe nivelit pagës aktualeminimale aktualishtë (pra nga muaj prill) është parashikuar të jetë 33,00 mln/lekë, nga 33,23 mln/lekë që është mbyllur viti 2022, ndërsa programi ishte 36,95 mln/lekë.

-Sigurime shoqërore, Referuar fondit të pagave të programuara shpenzimet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 5,51 mln/lekë, nga 6,17 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 5,55 mln/lekë).

-Materiale, Janë parashikuar materiale nga gjendja në depo dhe blerje të reja të nevojshme si:materjale për riparimin e mjeteve hekurudhore, dhe të tjera materiale konsumi me vlerë 8,00 mln/lekë, nga 6,90 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 20,57 mln/lekë). Gjithashtu siç përmendëm më lartë në rubrikën të ardhurave nga materjalet e investimeve buxhetore janë planifikuar shpenzime për materiale me fonde investimesh në vlerë 28,00 mln/lekë nga 20,00 mln/lekë e programuar në vitin 2022 (vlera e pritshme (fakt) është mbyllur me 6,43 mln/lekë).

-Lëndë djegëse, ku përfshihen: gazoil dhe vajra për automjetet e njësisë janë programuar 1,60 mln/lekë nga 0,75 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,43 mln/lekë).Ky shpenzim është parashikuar duke pasur parasysh volumin e punës së automjeteve, si edhe naftën teknologjike, çmimit mesatar të blerjes së gazoilit për vitin 2023, referuar këtu luhatjeve të tijë.

-Energji dhe ujë, Për vitin 2023 janë parashikuar 1,60 mln/lekë, nga 1,00 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 1,06 mln/lekë) Shpenzime këto që do të nevojiten për ambientet që disponon kjo njësi ,si magazina, zyra, godinat e reparteve etj.Duke u nisur nga fakti që Nj.SHML disponon borxhe ndaj OSHEE dhe UKD në vlerën prej 1,60 mln/lekë është parashikuar dhe likuidim nga pjesa e interesave.

-Udhëtim e dieta, Për vitin 2023 janë parashikuar 1.00 mln/lekë, nga 0,40 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,11 mln/lekë).Në planifikimin e këtij zëri janë patur parasysh volumet e pritshme të punës të parashikuar për vitin 2023, pra të levizjes së personelit për nevojat e aktivitetit nëpër stacionet hekurudhore për defekte të mjeteve hekurudhore apo avarive hekurudhore.

-Shpenzime telefonike. Për vitin 2023 janë parashikuar shpenzime telefonike në vlerën 0,04 mln/lekë, nga 0,06 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,04 mln/lekë). Shpenzime këto që në pjesën më të madhe janë për shkak të përdorimit të telefonisë fikse ndërmjet stacionet hekurudhore për defekte të mjeteve hekurudhore apo avarive hekurudhore.

-Amortizimi. Vlera e amortizimit për vitin 2023 është parashikuar të jetë 9,60 mln/lekë, nga 9,60 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 9,85 mln/lekë), vlerë kjo e cila përbën amortizimin e asetëve të llogaritur po me ato norma amortizimi të përdorura për vitin 2022. Normat e amortizimit; për asetet që disponon njësi janë llogaritur sipas normave të miratuara, në të gjitha rastet % kundrejt vlerës së mbetur. Normat e amortizimit të asetëve që nga viti 2006 janë llogaritur mbi bazën e normave teknike »të përshtatshme për sistemin hekurudhor« që janë miratuar nga ish MZHETS (sot MFE) me Vendim të Këshillit Mbikqyrës Nr.24 dt.18.12.2006.

-Zëri i shpenzimeve të tjera, Për vitin 2023 janë programuar 9,15 mln/lekë, nga 8,92 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi fakt është mbyllur me 8,83 mln/lekë), ku në këtë vlerë janë përfshirë; vlera e konsumit të veshmbathjeve dhe inventarit të imët me 0,04 mln/lekë, tatime e taksa automjetesh me 1,00 mln/lekë, dhe të tjera shpenzime me vlerë 8,11 mln/lekë, penalitete e gjoha, interesa, dalje jashtë përdorimi asete, etj.

-Zëri i shpenzimeve financiare, Janë programuar për vitin 2023 0,01 mln/lekë, nga 0,01 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 0,06 mln/lekë), ku në këtë vlerë janë përfshirë shpenzime për komisione bankare dhe interesa.

Krahas këtyre shpenzimeve direkte Nj.SHML ka edhe shpenzime që i përkasin marrëdhënieve të brendshme me HSH Qendër, **Shpenzime administrimi me HSH Qendër,** për vitin 2023 janë parashikuar në vlerën 24,52 mln/lekë nga 20,20 mln/lekë të programuara në vitin 2022 (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 20,12 mln/lekë).

Rezultati financiar, duke u bazuar në planifikimin aktual të programit të zhvillimit ekonomik, përfshirë këtu edhe të ardhurat dhe shpenzimet e brendshme mes njërive, parashikohet me humbje - 35,02 mln/lekë për vitin 2023, nga +11,00 mln/lekë që ishte programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi (fakt) është mbyllur me -2,69 mln/lekë.

e.HSH Qendër, (aktiviteti i drejtorisë së përgjithshme).

Të ardhurat.

Të ardhura nga aktiviteti kryesor për vitin 2023 janë programuar 576,40 mil/lekë nga 144,20 mil/lekë që janë parashikuar në vitin 2022, ndërsa ndaj të pritshmit (fakt) të vitit 2022 parashikohet një rritje prej 376,83 mil/lekë (i pritshmi (fakt) është mbyllur me 199,57 mil/lekë).

Ndikim të konsiderueshëm në rritjen e të ardhurave për vitin 2022 krahasuar me programin ka dhënë shtesa e subvencionit të akorduar nga shteti me vlerë 111 mil/lekë. Në rritjen e të ardhurave të programuara për vitin 2023 krahasuar me faktin e vitit 2022 ka jo vetëm përfshirja e subvencionit

por edhe vlera e skrapit e programuar në vitin 2022 me 98,80 mil/lekë, ndërsa për vitin 2023 kemi, parashikuar 42,00 mil/lekë.

Në rubrikën e të ardhurave janë përfshirë; të ardhurat nga kuota pjesë e asetëve të blera me fonde buxhetore me vlerë 44,00 mln/lekë, nga 45,00 mil/lekë e programuar në vitin 2022, i pritshmi (fakt) i vitit 2022 është mbyllet me vlerën 44,14 mil/lekë, pra me një ulje prej 0,14 mil/lekë.

Për këtë sqarojmë se sipas SKK 10 pika 5 e cila lidhet me grante të marra për aktive afatgjata materiale (“grantet dhe format të tjera të ndihmës” kërkon që grantet e marra për aktivet afatgjata materiale të kalojnë në të ardhura përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit). Ne duke qenë se përdorim norma amortizimi të asetëve shumë më të ulta se sa ato fiskale, prej vitesh ne kemi aplikuar kuotë pjesë me 10%, kjo sepse po ti përmbahemi kuotave të amortizimit që aplikojmë aktualisht do duhen shumë vite për të rimarë vlerën e tyre.

Bëjmë me dije se normat e amortizimit të asetëve që nga viti 2006 janë llogaritur mbi bazën e normave teknike» të përshtatshme për sistemin hekurudhor» që janë miratuar nga ish MZHETS (sot MFE) me vendim të Këshillit Mbikqyrës Nr.24 dt.18.12.2006. Të ardhura nga shitja e skrapit hekurudhor me vlerë 42,00 mil/lekë, nga 98,80 mln/lekë e programuar për vitin 2022, vlerë kjo e cila edhe mund të realizohet brenda këtij viti. Të ardhura të tjera si gjoba, interesa e të tjera të ardhura me vlerë 0,40 mil/lekë, nga 0,40 mil/lekë e programuar dhe faktit për vitin 2022. Krahas këtyre të ardhurave kemi dhe vlerën e subvencionit në shumën 490 mil/lekë.

Në HSH Qendër krahas këtyre të ardhurave janë programuar edhe të ardhura të brendëshme nëpërmjet marrëdhënieve mes njërive me vlerë 122,62 mln/lekë përkatësisht me Nj.B.Udhëtarë 36,78 mln/lekë, me Nj.B.Mallit me 24,52 mln/lekë, me Nj.BMIH 36,78mln/lekë dhe me Nj.SHML 24,52 mln/lekë. Në vitin 2022 janë programuar 101,00 mln/lekë, ndërsa i pritshmi (fakt) i vitit 2022 është mbyllur me 100,62 mil/lekë, përkatësisht, me Nj.B.Udhëtarë 30,19 mln/lekë dhe me Nj.B.Mallit me 20,12 mln/lekë me Nj.BMIH 30,19 mln/lekë dhe me Nj.SHML 20,12mln/lekë.

Shpenzimet:

-**Paga**, Për vitin 2022 sipas strukturës së miratuar numri i punonjësve është parashikuar me 50 punonjës, kjo si rezultat i reduktimit të numrit të punonjësve në tremujorin e katërt të vitit 2022.

Numri i punonjësve për vitin 2023 do të jetë i programuar me 61 punonjës, pra kemi një shtim të numërit me 11 punonjës, shtes kjo e cila vjen kryesisht tek njësia e projekteve (PMIU). Pra në total numri i punonjësve mesatar për vitin 2023 është parashikuar të jetë 61 punonjës dhe fondi i pagave referuar strukturës dhe nivelit pagës aktuale është parashikuar të jetë 49,20 mln/lekë, nga 33,66 mln/lekë e programuar në vitin 2022, ndërsa fakti është mbyllet me 29,91 mln/lekë.

-**Sigurime shoqërore**, Referuar fondit të pagave të programuara shpenzimet e sigurimeve shoqërore për vitin 2023 rezultojnë në vlerën 8,22 mln/lekë, nga 5,62 mln/lekë e programuar në vitin 2022 ndërsa fakti është mbyllur me 4,99 mln/lekë).

-Materiale, Janë parashikuar materiale nga gjendja në depo dhe blerje të reja të nevojshme si: materiale konsumi, shtypshkrime, kancelari, detergjent e të tjera me vlerë në total 1,00 mln/lekë, nga 1,00 mln/lekë e programuar në vitin 2022, ndërsa fakti është mbyllur me 0,75 mln/lekë.

-Lëndë djegëse, ku përfshihen; gazoil dhe vajra për automjetet e HSH qendër janë programuar 2,40 mln/lekë nga 1,80 mln/lekë e programuar në vitin 2022, fakti është mbyllet me 0,86 mln/lekë. Ky zë i shpenzimeve është parashikuar duke pasur parasysh volumin e punës së automjeteve, çmimit mesatar të blerjes së gazoilit për vitin 2023, referuar këtu luhatjeve të tijë. Nisur nga këto të dhënat për vitin 2023 sasia e naftës që nevojitet është rreth 10 mijë litra.

-Mallra, Për vitin 2023 janë parashikuar 10 mln/lekë, nga 12 të programuara për vitin 2022, fakti është mbyllur me zero mln/lekë, pra nuk u realizua shitja e skrapit (është realizuar pjesërisht në 3-mujorin e parë të vitit 2023). Këto shpenzime përfaqësojnë koston e skrapit hekurudhor të destinuar për shitje.

-Ujë, për vitin 2023 janë parashikuar 0,70 mln/lekë, nga 0,60 mln/lekë të programuara në vitin 2022 fakti është mbyllur me 0,08 mln/lekë, shpenzime këto që do të nevojiten për ambjentet që disponon HSH Qendër.

-Udhëtim e dieta. Për vitin 2023 janë parashikuar 1.60 mln/lekë, nga 1,40 mln/lekë të programuara në vitin 2022, fakti është mbyllur me 0,36 mln/lekë. Në planifikimin e këtij zëri është patur parasysh lëvizjet e personelit, për nevojat e aktivitetit nëpër stacionet që disponon HSH, por edhe lëvizjet jashtë vendi të personelit.

-Shpenzime telefonike. Për vitin 2023 janë parashikuar shpenzime telefonike në vlerën 0,60 mln/lekë, nga 0,40 mln/lekë të programuara në vitin 2022, fakti është mbyllet me 0,16 mln/lekë, shpenzime këto që në pjesën më të madhe janë për shkak të përdorimit të telefonisë fikse ndërmjet njësive, që komunikojnë mes tyre por edhe me të tretë jashtë ndërmarrje.

-Amortizimi. Vlera e amortizimit për vitin 2023 është parashikuar të jetë 0,60 mln/lekë, nga 0,60 mln/lekë të programuara në vitin 2022, fakti është mbyllur me 0,34 mln/lekë, vlerë kjo e cila përbën amortizimin e aseteve të llogaritur po me ato norma amortizimi të përdorura për vitin 2022.

Normat e amortizimit; për asetet që disponon HSH Qendër janë llogaritur sipas normave të miratuara, në të gjitha rastet % kundrejt vlerës së mbetur. Normat e amortizimit të aseteve që nga viti 2006 janë llogaritur mbi bazën e normave të eknike » të përshtatshme për sistemin hekurudhor» që janë miratuar nga ish MZHETS (sot MFE) me vendim të Këshillit Mbikqyrës Nr.24 datë 18.12.2006.

-Zëri i shpenzimeve të tjera, Për vitin 2023 janë programuar 48,30 mln/lekë, nga 40,68 mln/lekë të programuara në vitin 2022, fakti është mbyllur me rreth 42 mln/lekë. Në këtë vlerë janë përfshirë vlera e pagesave të personelit jashtë ndërmarrjes, si Këshilli Mbikqyrës me rreth 2,40 mln/lekë eksperta kontabël dhe vlerësues me rreth 33,10 mln/lekë, tatim taksa automjete me rreth 1,60 mln/lekë, gjoba dhe interesa me rreth 7,60 mln/lekë, dhe të tjera me rreth 3,60 mln/lekë, pagesa për punonjës në reformë dhe pension.

-Zëri i shpenzimeve financiare, Janë programuar për vitin 2023 3,60mln/lekë, nga 3,24 mln/lekë të programuara në vitin 2022, fakti është mbyllet me 3,60 mln/lekë ku në këtë vlerë janë përfshirë shpenzime për interesat e kredise me 3,20 mln/lekë dhe 0,40 mln/lekë shpenzime për komisione bankare.

Rezultati financiar, duke u bazuar në planifikimin aktual të programit të zhvillimit ekonomik, përfshirë këtu edhe të ardhurat dhe shpenzimet e brendshme mes njësive, parashikohet me plus 576,40 mln/lekë për vitin 2023, nga + 144,20 mln/lekë që ishte programuar në vitin 2022, ndërsa i pritshmi (fakt) është mbyllur me + 199,27 mln/lekë. Në vlerën e rezultatit pozitiv janë përfshirë të ardhurat e programuara nga aktiviteti kryesorë, sepse shpenzimet siç kemi përmendur më lart i janë shperndarë njësive të biznesit dhe shërbimeve

3. Numri punonjësve dhe fondi pagave, në total si HSH.

Numri mesatar i punonjësve programuar për vitin 2023 është 659 punonjës, nga të cilat 528 punonjës, ose rreth 80% e tyre pas rritjes së pagës minimale në 1 Prill 2023 dhe disa përmirësimeve të domosdoshme, trajtohen me pagë minimale. Duke bërë krahasimin me vitin 2022 kemi reduktim në ulje me 249 punonjës (programi i vitit 2022 është mesatarisht me 908 punonjës), ndërsa numri mesatar faktik i vitit 2022 është 826 punonjës, pra kemi 167 punonjës më pak. Viti 2022 është mbyllur me 641 punonjës)

Për vitin 2023 numri mesatar i punonjësve që është programuar për çdo njësi të HSH paraqitet; Nj.B.Udhetarë me 96 punonjës, nga 150 punonjës ne vitin 2022, Nj.B.Mallit me 91 punonjës nga 111 punonjës ne vitin 2022, Nj.BM.Infrastrukturës me 349 punonjës nga 510 punonjës ne vitin 2022, Nj.Shërbimit Mjeteve Levizëse me 62 punonjës nga 87 punonjës ne vitin 2022 dhe HSH Qendër me 61 punonjës nga 50 punonjës ne vitin 2022.

Referuar sa më sipër, alternativa e vetme në vazhdim për uljen e numrit të punonjësve, është:

- a. Ulja natyrale e tyre, nëpërmjet vetë largimeve të punonjësve dhe mos plotësimi vendeve të punës të mbetura vakant, që nuk kërkojnë domosdoshmërisht plotësimin e tyre.
- b. Mekanizimi i proceseve të punës kryesisht në mirëmbajtjen e linjave hekurudhore, nëpërmjet futjes së makinerive të posaçme, që kryejnë njëherësh disa procese pune. Por ky mekanizim është i lidhur me investimet buxhetore për blerjen e tyre.
- c. Përmirësimi i kohës së realizimit të transportit hekurudhor të mallit dhe përpunimit të vagonave, që do të zvogëlonte nevojën për orët e zgjatura pune dhe kostot përkatëse. Kjo realizohet me investime për përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore si dhe asaj logjistike.

E lidhur me arsyetimin e mësipërm për numrin mesatar të punonjësve si dhe vendimit për rritjen e pagës minimale në 40 mijë lekë që nga muaj Prill 2023, fondi i pagave për vitin 2023 është parashikuar 354,70 mln/lekë, duke konsideruar se numri më i madh i punonjësve trajtohen me pagë minimale. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore mbetet zëri kryesor i shpenzimeve operative për "Hekurudha Shqiptare" sh.a edhe pse për 10 vitet e fundit, deri në mbyllje të vitit 2022, numri i

punonjësve është ulur me rreth 1040 punonjës, ku vetem brenda vitit 2022 kemi një ulje me 333 punonjës.

4. Lënda djegëse, në total si HSH.

Në këtë zë shpenzimet janë planifikuar duke u bazuar në parashikimet e vëllimit të punës për çdo njësi të HSH-së për vitin 2023 dhe çmimi mesatar i furnizimit me lëndë djegëse për vitin 2022 dhe luhatjet e çmimit për vitin 2023, ku shpenzimet e këtij zëri siç kemi përmendur më lartë në çdo njësi të HSH janë të përcaktuara veçmas për çdo njësi bazuar në volumet e punës sipas përkatësisë.

Në këtë zë përveç gazoilit që nevojitet për procesin teknologjik të lokomotivave, dhe automjeteve e autoveturave që përdoren në aktivitetin e shoqërisë “operime dhe inspektime në teren, etj”, përfshihen dhe vajrat lubrifikant për këto mjete.

Ky zë shpenzimesh mbetet relativisht i lartë, si rezultat i vjetërimit të madh të mjeteve tërheqëse, (mbi 40 vjet përdorim “lokomotivat”), dhe për të cilat mungojnë investimet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe rinovimin e tyre. Për vitin 2023 janë programuar rreth 16,82 mil/lekë shpenzime për lëndë djegëse (gazoil, benzinë dhe vajra) nga 29,94 mil/lekë të programuara për vitin 2022, në krahasim me të pritshmin e vitit 2022 kemi rritje me 4,63 mln/lekë viti 2022 është mbyllet me 9,69 mln/lekë. Siç përmendëm më lartë detajimi i lëndës djegëse është pasqyruar në të dhënat e çdo njësie sipas përkatësisë. Në mënyrë të detajuar zërat e shpenzimeve dhe të ardhurave janë të pasqyruara në pasqyrat financiare bashkëlidhur këtij relacioni, si në p-programin e konsoliduar si HSH dhe të çdo njësie.

5. Rezultati, në total si HSH.

Rezultati për vitin 2023 parashikohet me humbje me vlerë - 344,93 mln/lekë, por duke i shtuar vlerën e fitimit të mbartur, kjo sipas standarteve të kontabilitetit me 282,80 mln/lekë (që përfaqëson diferencën e vlerës së amortizimit asetëve me vlerë të rivlersuar me vlerën e amortizimit me vlerë të rivlersuar), kjo humbje parashikohet të reduktohet në vlerën - 62,13 mln/lekë.

Bashkëlidhur këtij relacioni janë pasqyrat (tabelat) e përgatitura nga çdo njësi të HSH-së, referuar udhëzimit Nr.15 dt.02.05.2018 të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, pra pasqyrat e konsoliduara si HSH dhe pasqyrat për çdo njësi të HSH-së që japin në mënyrë të detajuar zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të ndara në periudha tre mujore.

6. Karakteristika të tjera të HSH.

6.1 Investimet.

Hekurudha Shqiptare sha. parashikon të zhvillojë aktivitetin e vet përkundër vështirësive të ndryshme. Këtu duhet patur parasysh se përveç shpenzimeve operacionale të domosdoshme për funksionim, nevojiten edhe burime financiare për projekte kapitale. Aktualisht burimi i vetëm për këto investime është Buxheti i Shtetit. Nga ky burim, HSH financohet për investime në projektet kapitale siç janë riparimi/modernizimi i infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve lëvizëse nëpërmjet blerjes së mjeteve të përdorura apo të reja. Investimet nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023 në total

janë parashikuar 550,00 milion lekë, (nga 396,42 milion lekë të parashikuara për vitin 2022, i pritshmi parashikohet të mbyllet me 400 milion lekë), e formuar nga 150,00 mln/lekë ndërtime dhe montime, 53 mln/lekë makineri dhe paisje, 4,00 mln/lekë paisje dhe orendi, 113,00 mln/lekë studime, projektme dhe shpronsime dhe 230,00 mln/lekë investime të tjera (+tvsh).

Përveç sa më sipër, për vitin 2023 janë parashikuar dhe 3.378,35 mln/lekë investime me financim të huaj "kredi dhe grante", (nga 1.958,35 mln/lekë të parashikuara për vitin 2022), ku financimet e huaja me kredi dhe grante përfaqësohen; rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Tiranë-Rinas me 3.112,65 mln/lekë, hartimi i projektit detajuar i linjës terminali transportit publik, zgjatimi Durrës-Tiranë km 4 me 67,10 mln/lekë, hartimi i projektit preliminar Rrogozhinë-Pogradec-Lin me 81,60 mln/lekë, dhe studimi i fizibilitetit dhe projekt-ide i linjës Durrës-Prishtinë me 117 mln/lekë.

Gjykuar me nevojat reale me rreth 1 miliard lekë që do të nevojiteshin për mirëmbajtjen e linjës hekurudhore dhe të mjeteve lëvizëse të saj, fondi prej 550,00 mln/lekë i investimeve buxhetore të programuara është mjaft i vogël edhe pse me një rritje në këtë vitë me 153,58 mln lekë më shumë se sa fondi i akorduar në vitin 2022.

6.2. Subvencioni.

Subvencioni, që shërben për mbulimin e shpenzimeve operative në transportin hekurudhor (rrjeti hekurudhor i subvencionuar), është programuar 490 mln/lekë, nga 511 mil/lekë që ishte fakti i vitit 2022, kjo duke iu referuar ligjit për buxhetin e shtetit për vitin 2023 të Republikës së Shqipërisë, "Subvencioni i Hekurudhës Shqiptare" publikuar në faqen zyrtare të MFE është 490 mil/lekë.

Nënvizojmë se rritja e nivelit të pagës minimale që nga muaji Shtator 2022 dhe aktualisht në muajin Prill 2023 ka dhënë efekt negativ në përballimin e pagesave për detyrimet fiskale dhe borxheve të tjera të mbartura, ku nënvizojmë se shtesa e subvencionit për vitin 2022 me 111 mil/lekë bëri të mundur likuidimin e detyrimeve fiskale të trashëguara dhe uljen e detyrimeve të tjera ndaj të tretëve me rreth 35 mil/lekë. Duke qënë se fondi për paga dhe sigurime shoqërore/shëndetësore është pjesë e shpenzimeve operative, disa herë kemi kërkuar zyrtarisht rishikim të subvencionit me sens rritje.

7. Probleme tepër shqetësuese.

Situata financiare paraqitet në gjëndje kritike pasi rezultat i gjëndjes së likuiditeteve varet shumë nga realizimi i të ardhurave nga ankandi i skrapit (shitja e disa prej asetëve të HSH-së) gjatë vitit 2023, për të cilën ne kemi parashikuar 42,00 mln lekë. Nëse ky ankand nuk realizohet, atëherë situata e likuiditeteve ndryshon.

Gjithashtu ndikim të fortë do ketë nëse ura e Ishmit nuk riparohet, për të mundësuar transportin të paktën deri në stacionin e Vorës, pasi ndikon direkt në reduktimin e ndjeshëm të të ardhurave nga transporti ndërkombëtar i mallit (si rezultat i uljes së distancës së kryer), që aktualisht përbën 90% të totalit të të ardhurave nga transporti mallit.

Pagesa e kredisë Italiane për vitin 2023, do të vazhdojë të mbetet problem, duke nënvizuar se HSH do ta ketë shumë të vështirë, për të mos thënë të pamundur shlyerjen e saj. Siç ju kemi vënë në dijeni

deri ne vitin 2022 dhe për vitin 2023 nuk kemi qenë dhe nuk do të jemi në gjendje që ta shlyenim këtë kredi dhe interesat e saj.

Në mbyllje të 3- mujorit parë të vitit 2023, detyrimet kreditore (borxhet) rezultojnë të jenë:

Nr	Emertimi	Njësia	Periudha	Vlerë
1	Detyrime Fiskale	Mln/lekë	Deri ne muajn Mars 2023	7,27
2	Kastrati Sha (gazoil)	Mln/lekë	Deri ne muajn Mars 2023	13,92
3	Bolv Oil TIRANE	Mln/lekë	Deri ne vitin 2014	14,16
4	SkenderiG+Europetrol	Mln/lekë	Deri ne vitin 2012	0,54
5	Roje Private	Mln/lekë	Deri ne vitin 2016	28,95
6	Eksper auditues dhe vlersues	Mln/lekë	nga viti 2017 deri viti 2023	39,93
7	Detyrime ndaj buxhetit per qerate e objekteve	Mln/lekë	Periudha 2009-2021	25,93
8	Detyrime ndaj furnitoreve per blerje materjale	Mln/lekë	Periudha 2022-2023	3,08
9	Detyrimendaj OSHEE per energji elektrike	Mln/lekë	Periudha 2016-2023	34,30
10	Detyrimet e hekurur.te huaja (ore qendrime)	Mln/lekë	Periudha 2009-2023	225,80
11	DPSHTRR Taksat e automjeteve	Mln/lekë	Periudha 2016-2023	2,40
12	Detyrimet e hekur..të huaja (interesa)	Mln/lekë	Periudha 2009-2023	59,20
13	Eco Projekt Alb. (PIU)	Mln/lekë	Periudha 2021/03	2,68
14	Instituti I Ndërtimit (PIU)	Mln/lekë	Periudha 2022/06	3,20
15	CER aisbl (antarsimi)	Mln/lekë	Periudhavitin 2019	3,59
16	Detyrimet e klienteve për parapagime	Mln/lekë	Periudha 2020-2023	12,15
17	Detyrimet e pagesave të punonjësve	Mln/lekë	Periudha Mars 2023	22,29
18	Të tjera detyrime	Mln/lekë	Periudha 2020-2023	15,23
	Shuma			514,62
	Detyrime per Kredi dhe Grande			
1	Kredia Italiane	Mln/lekë	Deri 1998	58,99
2	Ministria Finances dhe Ekonomise (per kredin)	Mln/lekë	Periudha 2009-2022	303,83
3	Kredia Bankes Boterore	Mln/lekë	Periudha 2003-2004	107,05
4	GrantiJ aponez	Mln/lekë	Periudha 2003-2004	187,85
	Shuma			657,72
	Detyrime per hekurudhat e huaja (vjetera)			
1	Borxhi ndaj hekurudhave të huaja	Mln/lekë	Deri ne vitin 1995	781,47
	Shuma			781,47
	TOTALI I BORXHEVE			1953,81

Niveli tepër i ulët i të ardhurave nga transporti sidomos atij të mallrave, gjëndja e rënduar teknike e infrastrukturës dhe mjeteve lëvizëse si pasojë e vjetërimit të madh dhe mungesës së investimeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe rinovimin e tyre, vështirësitë e mëdha në:

- pagesat cash për blerjen e naftës për lëvizjen e trenave,
- në pagesat për sigurimet shoqërore/shëndetësore të punonjësve,
- pagesat e detyrimeve nëpërmjet përmbaruesve,

gjë që e bëjnë dhe më të vështirë vazhdimësinë e aktivitetit dhe drejtimin e Shoqërisë.

Detyrimet ndaj hekurudhave të huaja dhe furnitorëve të brëndshëm, ku disa prej tyre si kredia italiane, kredia e Bankës Botërore dhe Granti Japonez, apo orë qëndrimet e vagoneve të huaj, janë futur në kufitë e pamundësisë së shlyerjes.

. E konsiderojmë të nevojshme të përmendim që nga hekurudhat e huaja përveç detyrimeve të vjetra dhe ato të periudhës 2009-2023, pra principialit, na kërkohet edhe shlyerja e interesave.

Në detyrimet e periudhës 2009-2022, Hekurudha Sërbe përveç detyrimet prej 532.044 mijë euro, kërkon edhe 359.331 mijë euro interesa. Po kështu Hekurudha Hungareze përveç detyrimit prej 262.340 mijë euro, kërkon edhe 154.305 mijë euro interesa.

Problem me detyrimet e vjetra të ish Hekurudhës Jugosllave, kemi ndarjen e detyrimeve për secilën hekurudhë që egziston pas shpërbërjes së sajë, pasi në pasqyrat financiare ne i kemi ish Hekurudha Jugosllave. Pas ndarjes së tyre, ne nuk disponojmë dokumenta, që të mund të ndajmë dhe detyrimet për secilën hekurudhë që egziston aktualisht. Në muajn Mars 2023 ne i jemi drejtuar secilës hekurudhë sipas Shteteve që i përkasin për të na konfirmuar detyrimet.

Lidhur me detyrimet ndaj hekurudhave të huaja, gjykojmë që nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas përkatësisë së çdo shteti që i përkasin këto borxhe, të mundësohet një marrëveshje ndërshtetërore. Nisur nga fakti që pjesa më e madhe e këtyre detyrimeve, janë shumë të vjetra (mbi 25 vite), mund të kërkohet edhe falja e tyre.

Për detyrimet që i përkasin periudhës 2009-2023, ne gjykojmë ndërmjetesimin e Shtetit nëpërmjet marrëveshjeve ndërshtetërore që të mundësohet falja e interesave dhe likuidimi i tyre pjesë-pjesë, pra të principalit sipas mundësive financiare që ne do të kemi për periudhën në vazhdim.

Në tabelën përmbledhëse të projekt-programit “të konsoliduara“ janë pasqyruar zerat e treguesve të të ardhurave dhe shpenzimeve, ku në këto tabela nuk janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e brendëshme ndërmjet njësisive, sepse nuk kanë efekte financiare, pra në rezultat.

Në tabelën përmbledhëse të projekt-programit të zhvillimit, të detajuar sipas njësisive janë pasqyruar treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit kryesor si dhe treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve të brendshme që kanë njësitë ndërmjet tyre.

Njësia e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore për vlerën e taksës së infrastrukturës me 29,35 mln/lekë, i ka kaluar Nj. Biznesit Mallit 1,13 mln/lekë dhe Nj. Biznesit Udhëtarë 28,22 mln/lekë. Sqarojmë se kjo vlerë për Nj. Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore raportohet si e ardhur e brendshme, ndërsa për dy njësitë e Mallit dhe të Udhëtarëve raportohen si shpenzime të brendshme.

Njësia Shërbimit Mjeteve Lëvizëse shpenzimet e saj prej 51,00 mln/lekë i ka kaluar dy njësisive të biznesit Nj. BM me 28,30 mln/lekë dhe Nj. BU me 22,70 mln/lekë. Për Nj. SHML kjo vlerë raportohet si e ardhur e brendshme ndërsa për dy njësitë e biznesit si shpenzime të brendshme.

Shpenzimet e HSH Qendër prej 122,62 mln/lekë u janë kaluar katër njësisive të HSH-së përkatesisht; Nj. SHML me 24,52 mln/lekë, Nj. BU me 36,78 mln/lekë, Nj. BM me 24,52 mln/lekë dhe Nj. B.MIH

me 36,78 mln/lekë. Për Dr.Përgjithshme (HSH qendër) kjo vlerë raportohej si e ardhur e brendshme ndërsa për katër njësitë si shpenzime të brendshme.

Ju bëjmë me dije se këto veprime kryhen vetëm për efekt analize të brendshme për çdo njësi të HSH-së.

Në total si të ardhurat edhe shpenzimet e brendshme ndërmjet njësive janë me vlerë 202,97 mln/lekë, vlerë kjo e cila nuk ndikon në rezultatin e përgjithshëm të shoqërisë, sepse nëse do të përfshihej kjo vlerë, të ardhurat do rriteshin fiktivisht me 202,97mln/lekë si dhe shpenzimet po me të njëjtën vlerë do rriteshin fiktivisht. Për këtë theksojmë se, në pasqyrat përmbledhëse “e konsoliduar“ të Shoqërisë si tek të ardhurat dhe në shpenzime nuk është përfshirë vlera 194.56 mln/lekë, sepse nuk ka efekte financiare në rezultatin e përgjithshëm të shoqërisë.

Në bazë të llogaritjeve të bëra për vitin 2023 janë paraqitur dhe parashikimet për vitin 2024 dhe 2025.

Bashkëlidhur këtij relacioni janë pasqyrat e projekt programit ekonomik të detajuara si Shoqëri (HSH) të konsoliduara, si dhe detajimi për çdo Njësi të HSH-së.


ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Gentian LIKO



P/PROGRAMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2023 DHE PARASHIKIMI PËR VITET 2024 DHE 2025.

NR	Emërtimi	Njësia Matëse	Realizimi në Vitin 2021	VITI 2022			Projekt-programi vjetor 2023	P/PProgrami vitit 2023				P/Programi vjetor 2023 ndaj të pritshmit 2022, në %	Parashikim i për vitin 2024	Parashikim i për vitin 2025
				Programi	I pritshmi vjetor (Fakt)	Në %		Ndarrë në tremujor						
								I	II	III	IV			
I	Transport Gjithsej	Min/lekë	57.71	23.90	3.49	14.60	6.45	1.30	1.92	1.87	1.36	184.8	6.7	7.0
A	Transport Malli	Min/lekë	56.56	22.70	2.36	10.4	5.25	1.10	1.52	1.42	1.21	222.5	5.51	5.79
B	Transport Udhëtarë	Min/lekë	1.15	1.20	1.13	94.2	1.20	0.20	0.40	0.45	0.15	106.2	1.20	1.20
II	Transport malli në natyrë:													
-	Hekurudha në ton	000/Ton	75.25	31.00	3.67	11.8	7.89	1.66	2.29	2.13	1.81	215.0	8.28	8.69
-	Hekurudha në ton/km	000/Tkm	5.661	2.700	285	10.6	670	141	194	181	154	234.8	704.12	739.32
III	Transport udhëtarë në natyrë:													
-	Hekurudha në Udhëtarë	000/Udh.	24.02	21.50	10.60	49.3	21.50	3.80	8.80	6.70	2.20	202.8	21.50	21.50
-	Hekurudha në Udhëtarë/Km	000/Ukm	812.00	780.00	437.00	56.0	780	150	290	260	80	178.5	720	720
III	Eksporti Gjithsej	000/Euro	-	-	-	0.0	-	-	-	-	-	-	-	-
IV	Investime gjithsejtë	Min/lekë	196.81	2,354.77	2,017.45	85.68	3,928.349	844.592	1,008.192	1,075.282	1,000.282	194.7	3,872.39	3,862.39
	Nga keto :													
A	Investime me financim të brendshëm	Min/lekë	196.81	396.42	394.58	99.5	550.00	-	163.60	230.70	155.70	139.4	570.00	550.00
1	Ndërtime dhe Montime	Min/lekë	58.17	31.56	62.79	199.0	150.00	-	30.00	71.00	49.00	238.9	126.00	139.00
2	Makinieri dhe Pajisje	Min/lekë	8.27	67.00	-	0.0	53.00	-	14.00	26.00	13.00	-	46.00	37.00
3	Pajisje dhe Orendi	Min/lekë	0.84	1.00	1.89	189.0	4.00	-	2.00	2.00	-	211.6	-	4.00
4	Studime ,Projektme dhe Shpronsime	Min/lekë	0.00	96.00	102.00	106.3	113.00	-	41.00	55.00	17.00	110.8	148.00	140.00
5	Investime të tjera (+ TVSH)	Min/lekë	129.53	200.86	227.90	113.5	230.00	-	76.60	76.70	76.70	100.9	250.00	230.00
B	Investime me financim të huaj	Min/lekë	0.00	1,958.35	1,622.87	82.9	3,378.349	844.592	844.592	844.582	844.582	208.2	3,302.39	3,302.39
1	Rehabilitimi i linjës heku.Durrës-Tiranë-Rinas	Min/lekë	0.00	1,865.00	1,609.88	86.3	3,112.649	778.162	778.162	778.162	778.162	193.3	3,202.39	3,202.39
2	Studimi fizibilitetit, lidhjen hek.Pogradec-Greqi	Min/lekë	0.00	0.00	0.00	0.0	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Hartimi projektit,rehabil.linjës Vor-Hani Hotit (M-Z)	Min/lekë	0.00	17.00	12.99	76.4	-	-	-	-	-	-	-	-
4	Hartimi projektit,preliminar Rogozhin-Pogradec-Lin	Min/lekë	0.00	15.00	0.00	0.0	81.60	20.40	20.40	20.40	20.40	-	100.00	100.00
5	Hartimi proj.dejat,linjes terminali trans.pub.zgjat Dr-Tr km4	Min/lekë	0.00	0.00	0.00	0.0	67.10	16.78	16.78	16.77	16.77	-	-	-
6	Hartimi projektit,rehabilitimin linjës Durrës-Rrogozhin	Min/lekë	0.00	31.35	0.00	0.0	-	-	-	-	-	-	-	-
7	Plani i menaxhimit asetëve dhe metodologjia tarifkimit ne HSH	Min/lekë	0.00	0.00	0.00	0.0	-	-	-	-	-	-	-	-
8	Studi.fizibilitete,dhe proj.-ide linja Durrës-Prishtin	Min/lekë	0.00	30.00	0.00	0.0	117.00	29.25	29.25	29.25	29.25	-	-	-
C	Sipas burimit financimit	Min/lekë	196.81	396.42	394.58	99.5	550.00	-	163.60	230.70	155.70	139.4	570.00	550.00
1	Burimet e veta	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Buxheti i shtetit	Min/lekë	196.81	396.42	394.58	99.5	550.00	-	163.60	230.70	155.70	139.4	570.00	550.00
D	Ndihmë e kredi dhe huaj	Min/lekë	0.00	1,958.35	1,622.87	82.9	3,378.35	844.59	844.59	844.58	844.58	208.2	3,302.39	3,302.39



NR	Emërtimi	Njësia Matjes	Realizimi në Vitin 2021	VITI 2022			P/Programi vitit 2023				P/Programi vjetor 2023 ndaj të pritëshmit 2022, në %	Parashikim i për vitin 2024	Parashikim i për vitin 2025
				Programi	I pritëshmi vjetor (Fakt)	Në %	Ndarë në tremujor						
							I	II	III	IV			
V	Treguesit e Punës												
1	Punonjës gjithsej	Nr.mesat.	936,00	908,00	827,00	91,1	659	659	659	659	79,7	659	659
2	Fondi pagave gjithsej	Min/lekë	381,70	392,09	344,87	88,0	354,70	77,80	92,30	92,30	77,20	371,00	371,00
3	Paga mesatare	leke	33.383	35.945	34.751	96,7	44.853	39,35	46,69	46,69	129,1	46,92	46,92
4	Fond page për punonjës ne reforme dhe pension	Min/lekë	4,70	2,00	14,86	743,0	3,60	1,00	0,80	0,80	24,2	2,50	2,50
5	Sigurime shoqërore/Shëndetësore	Min/lekë	64,14	65,48	58,02	88,6	59,23	12,99	15,41	15,41	102,1	61,96	61,96
VI	Treguesit Financiar												
A	Të ardhura (Pa subvencionin)	Min/lekë	136,65	268,80	295,76	110,0	167,49	60,81	21,66	21,61	56,6	134,91	136,72
	Nga keto, sipas burimeve,												
1	Nga Transport Malli	Min/lekë	56,56	22,70	2,36	10,4	5,25	1,10	1,52	1,42	222,5	5,51	5,79
2	Nga Transport Udhëtarë	Min/lekë	1,15	1,20	1,13	94,2	1,20	0,20	0,40	0,45	106,2	1,20	1,20
3	Nga Burime të tjera	Min/lekë	128,94	244,90	292,27	119,3	161,04	59,51	19,74	19,74	55,1	128,20	129,73
	Nga kjo	Min/lekë											
a	Të ardhura,materiale konsumit me fonde buxhetore	Min/lekë	14,99	83,00	13,85	16,7	53,00	13,25	13,25	13,25	382,7	61,00	62,00
b	Rimafje nga investimet buxhetore (kuotë 10%)	Min/lekë	42,39	45,00	44,14	98,1	44,00	-	-	-	99,7	43,00	42,00
c	Të ardhura nga qeradhënia	Min/lekë	2,91	3,00	3,36	112,0	3,35	0,82	0,84	0,84	99,7	4,00	4,00
d	Të ardhura nga shiija e skrapit (tjetërsim aktive vagona)	Min/lekë	21,62	62,80	0,00	0,0	-	-	-	-	-	-	-
d.1	Të ardhura nga shiija e skrapit (tjetërsim aktive shina)	Min/lekë	0,00	36,00	0,00	0,0	42,00	42,00	-	-	-	-	-
e	Të ardhura të tjera jashtë aktiviteit kryesorë	Min/lekë	47,03	15,10	230,92	1.529,3	18,69	3,44	5,65	5,65	8,1	20,20	21,73
4	Të tjera të ardhura të vlerës (difer.amortizimi)	Min/lekë	374,73	288,80	2.268,64	785,5	282,80	-	-	-	12,5	280,50	277,80
B	Të ardhura nga Subvencionin	Min/lekë	400,00	390,00	501,00	128,5	490,00	122,50	122,50	122,50	97,8	510,27	510,27
C	Të ardhura gjith. (A+B)	Min/lekë	961,38	947,60	3.065,40	323,5	940,29	183,31	144,16	144,11	166,90	925,68	924,79
D	Shpenzimet Gjithsej (1+2+3+4)	Min/lekë	1.073,80	1.106,72	3.071,14	277,5	1.002,42	241,90	250,24	252,75	32,6	1.006,83	1.004,58
	Nga këto												
1	Paksimi gjendjes prodhimit në proces	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Shpenzime te shfrytëzimit e rrjedhëse	Min/lekë	1.008,74	1.097,75	3.041,03	277,0	992,65	238,65	248,60	249,51	32,6	996,88	995,33
-	Materiale të para e materiale të tjera	Min/lekë	63,60	129,54	45,51	35,1	84,52	21,07	21,09	21,19	185,7	95,21	97,02
	Nga kjo	Min/lekë											
-	a.Materiale konsumit me fonde buxhetore	Min/lekë	14,99	83,00	13,85	16,7	53,00	13,25	13,25	13,25	382,7	61,00	62,00
-	b.Materiale të tjera (me fonde të brendshme)	Min/lekë	13,98	16,60	21,97	132,3	14,70	3,62	3,63	3,73	66,9	16,13	16,66
-	c.Karburant	Min/lekë	34,63	29,94	9,69	32,4	16,82	4,20	4,21	4,21	173,6	18,08	18,36
-	Mallra	Min/lekë	4,24	12,00	0,00	0,0	10,00	-	-	-	-	-	-
-	Shërbime gjithsejtë	Min/lekë	0,38	1,86	0,40	21,5	1,94	0,48	0,49	0,48	485,0	2,94	2,94
	Nga kjo, për shpenzime telefona celular	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Furnitura	Min/lekë	19,41	45,90	2.135,46	4.652,4	35,18	8,80	8,78	8,79	1,6	34,15	34,73

[Signature]

[Stamp: BURESI I TREGUESIT FINANCIAL, HEKURUDHA SHQIPTARE]

NR	Emërtimi	Njësia Matjes	Realizimi në Vitin 2021	VITI 2022		Projekt-programi vjetor 2023	P/Programi vitit 2023				P/Programi vjetor 2023 ndaj të pritshmit 2022, në %	Parashikim i për vitin 2024	Parashikim i për vitin 2025	
				Programi	I pritshmi vjetor (Fakt)		Në %	Ndarë në tremujor						
								I	II	III				IV
-	Paga Personeli	Min/lekë	381,70	392,09	344,87	88,0	354,70	77,80	92,30	92,30	92,30	102,9	371,00	371,00
-	Fond page për punonies ne reforme dhe pension	Min/lekë	4,70	2,00	14,86	743,0	3,60	1,00	1,00	0,80	0,80	-	2,50	2,50
-	Sigurime Shoqërore/Shëndetësore	Min/lekë	64,14	65,48	58,02	88,6	59,23	12,99	15,41	15,41	15,41	102,1	61,96	61,96
-	Shpenzime të tjera	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Tatim dhe Taksa	Min/lekë	0,16	3,60	0,81	22,5	3,60	0,90	0,90	0,90	0,90	444,4	3,80	4,00
-	Shpenzime të tjera rrjedhëse	Min/lekë	128,05	48,60	127,94	263,3	48,68	7,81	10,83	11,83	18,21	38,0	40,62	41,78
-	a.Kosto bileta	Min/lekë	0,01	0,10	0,01	10,0	0,10	0,02	0,03	0,03	0,02	1.000,0	0,10	0,10
-	b.Pagesa jashtë ndërmarrjes (pritie e percjellje)	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	c.Konsumi i veshmbathjeve dhe inventarit të imet	Min/lekë	0,53	1,72	0,18	10,5	1,34	0,33	0,34	0,34	0,33	744,4	1,43	1,43
-	d.Të tjera jashtë ndërmarrjes (KM dhe Ekspert)+tjera	Min/lekë	127,51	46,78	127,75	273,1	47,24	7,46	10,46	11,46	17,86	37,0	39,09	40,25
-	Shpenzime Amortizimi	Min/lekë	342,36	396,68	313,17	78,9	391,20	97,80	97,80	97,80	97,80	124,9	384,70	379,40
-	Shpenzime për Provizione	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Pjesa e të ardhurave nga qiradhënia bruto e cila derdhet nga Shoqëria ne buxhetin e Shtetit	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime financiare	Min/lekë	5,06	8,97	30,11	335,7	9,77	3,25	1,64	3,24	1,64	32,4	9,95	9,25
4	Shpenzime të jashtëzakonshme	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
E	Fitimi para tatimit	Min/lekë	-52,42	-159,12	-5,74	3,6	62,13	-58,59	-106,08	-108,64	211,19	1.082,5	81,14	79,78
F	Derdhjet në buxhet	Min/lekë	5,40	8,80	5,40	61,4	9,20	2,20	2,30	2,40	2,30	170,4	10,90	11,00
a	Aksize	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
b	Taksa rrugore	Min/lekë	0,40	0,80	0,40	50,0	0,80	0,20	0,20	0,20	0,20	200,0	0,90	1,00
c	Taksë mbi pasurin e patundshme	Min/lekë	0,20	-	0,20	-	-	-	-	-	-	-	-	-
d	Tatimi mbi të ardhurat personale	Min/lekë	4,80	8,00	4,80	60,0	8,40	2,00	2,10	2,20	2,10	175,0	10,00	10,00
e	TVSH	Min/lekë	-	0,00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
f	Tatim fitim	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
G	Fitimi neto	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Nga kjo	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Rezerve e domosdoshme	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Dividenti	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
-	Rezerva të tjera	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VII	Treques specifike për Shoqërinë	Min/lekë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

 DREJTUES I NJËSISË EKONOMIKE
 Avdi HALLULLI

 ADMINISTRATORI I SHOQËRISË
 Gentian LIKO


Vlera e borxheve që Hekurudha Shqiptare ka gjendje më datë 31.03.2023.

Ne mln leke

Nr	Emertimi	Njesia	Periudha	Vlere			
1	Detyrime Fiskale	Min/lekë	Deri ne muajin Mars 2023	7,27			
2	Kastrati Sha (gazoil)	Min/lekë	Deri ne muajin Mars 2023	13,92			
3	Bolv Oil TIRANE	Min/lekë	Deri ne vitin 2014	14,16			
4	Skenderi G+Europetrol	Min/lekë	Deri ne vitin 2012	0,54			
5	Roje Private	Min/lekë	Deri ne vitin 2016	28,95			
6	Ekspert auditues dhe vlersues	Min/lekë	nga viti 2017 deri ne vitin 2023	39,93			
7	Detyrime ndaj buxhetit per qerate e objekteve	Min/lekë	Periudha 2009-2021	25,93			
8	Detyrime ndaj furnitoreve per blerje materjale	Min/lekë	Periudha 2022-2023	3,08			
9	Detyrime ndaj OSHEE per energjielektrike	Min/lekë	Periudha 2016-2023	34,30			
10	Detyrimet e hekurudhate huaja (ore qendrime)	Min/lekë	Periudha 2009-2023	225,80			
11	DPSHTRR Taksat e automjeteve	Min/lekë	Periudha 2016-2023	2,40			
12	Detyrimet e hekurudhate huaja (interesa)	Min/lekë	Periudha 2009-2023	59,20			
13	Eco Projekt Alb. (PIU)	Min/lekë	Periudha 2021/03	2,68			
14	Instituti i Ndertimit (PIU)	Min/lekë	Periudha 2022/06	3,20			
15	CER aisbl (antarsimi)	Min/lekë	Periudha vitin 2019	3,59			
16	Detyrimet e klienteve per parapagime	Min/lekë	Periudha 2020-2023	12,15			
17	Detyrimet e pagesave te punonjeseve	Min/lekë	Periudha Mars 2023	22,29			
18	Te tjera detyrime	Min/lekë	Periudha 2020-2023	15,23			
	Shuma			514,62			
	Detyrime per Kredi dhe Grande						
1	Kredia Italiane	Min/lekë	Deri 1998	58,99			
2	Ministria Finances dhe Ekonomise (per kredin)	Min/lekë	Periudha 2009-2022	303,83			
3	Kredia Bankes Boterore	Min/lekë	Periudha 2003-2004	107,05			
4	Granti Japonez	Min/lekë	Periudha 2003-2004	187,85			
	Shuma			657,72			
	Detyrime per hekurudhat e huaja (vjetera)						
1	Borxhi ndaj hekurudhave te huaja	Min/lekë	Deri ne vitin 1995	781,47			
	Shuma			781,47			
	TOTALI I BORXHEVE			1953,81			
			Totali i te tjerave				
		403	4672	404	437	466	Totali
		1,26	3,65	0,50	0,12	9,7	15,23



[Handwritten signature]

Në mln/lekë

NR	Projekti qarkullimit monetar	VITI 2023
	Hyrjet e mjete monetare cash	
1	Të ardhura nga shitja (mall e udhëtarë)	6,45
	Nga kjo	
	Shitje në cash (me arke direkt)	
	a.Nga udhëtarë	1,20
2	Të ardhura të tjera	52,65
	a. Shitje skrap (Shina sipas raportit ekspertit)	42,00
	b.Magazinazh dhe qira	3,35
	c.Të tjera (interesa, konvertim nga monedha e huaj, etj)	7,30
I	TOTALI CASH NGA SHITJET(1+2)	59,10
1	Te ardhurat nga financimet	490,00
	a.Nga Subvencioni	490,00
II	TOTALI TË ARDHURA NGA FINANCIMET	549,10
III	Te ardhura nga gjendja 31.12.2022	3,32
A	TOTALI I HYRJEVE TË MJETEVE MONETARE	552,42
	SHPENZIME NË CASH	
1	Kosto mallnave (materjale)	31,00
	Nga kjo :	
	Materjale konsumi	3,00
	Karburant (viti 2023 dhe detyrim i trashëguar)	28,00
2	Paga,asistencë dhe sig.shoqërore/shëndetësore	413,93
3	Qera repetitori	
4	Siguracine të ndryshme te mjeteve levizese	1,50
5	Interesat (kredia Italiane)	
6	Pagesa kredise Italiane	
7	Kuatizazione për organizma ndërkombëtare	
8	Udhëtim dhe dieta	5,00
9	Roje private (detyrime te mbartura)	25,00
10	Energji elektrike dhe ujë	28,00
11	Telefon	0,50
12	Blerje bileta transporti udhëtarë (kosto)	0,10
13	Riparim nga të tretë	1,50
14	Taksa,detyrime të tjera,TVSH	0,50
15	Të tjera Jasht Ndërmarrje (ekspert vlersues dhe auditues)	40,00
16	Transporti me jashtë	1,00
17	Komisione bankare	1,50
18	Të tjera (gjoba e demshperblime nga organet gjyqesore)	2,00
	TOTALI DALJEVE MONETARE	551,53
	Celja bilançit vitit 2024	0,89



P-PROGRAMI ZHVILLIMIT EKONOMIK PËR VITIN 2023 ,DHE PARASHIKIMI PËR VITET 2024, 2025.
TOTALI SI HSH.




Shkresa nr.844 dt.17.08.2022 (Nr.2)

NR	Emërtimi	Njësia Matëse	Realizimi në vitin 2021	Viti 2022			Vjetor	P-Programi vitit 2023				P-Programi vjetor 2023 ndaj të pritsimit (Fakt) 2022 në %	Parashikimi për vitin 2024	Parashikimi për vitin 2025
				Programi	I pritshmi (FAKT)	Ne %		Ndarë në tremujor						
								I	II	III	IV			
I	Transport udhëtarë në natyrë.													
-	Në Udhëtarë	000Udh.	24.02	21.5	10.6	49.3	21.50	3.80	8.80	6.70	2.20	202.8	21.5	21.5
-	Në Udhëtar/Km	000U/Km	812.00	780	437	56.0	780.00	150.00	290.00	250.00	80.00	178.5	720	720
II	Transport malli në natyrë.													
-	Në tonë	000Ton	75.25	31.00	3.67	11.8	7.89	1.66	2.29	2.13	1.81	215.0	6.28	8.69
-	Në ton/km	000T/Km	5661.00	2700.00	285.40	10.6	670.59	140.82	194.47	181.06	154.24	235.0	704.12	739.32
		Minleke	196.81	2,354.77	2,017.45	85.7	3,928.349	844.593	1,068.192	1,075.282	1,000.282	194.7	3,872	3,852
III	Investime gjithsejtë													
IV	Treguesit e Punës	Minleke	445.83	457.57	402.89	88.0	413.93	90.79	107.71	107.71	107.71	102.7	432.96	432.96
a.	Për punonjësit në punë													
1	Punonjës gjithsej	Nr.mes.	937	908	827	91.1	659	659	659	659	659	79.7	659	659
2	Fondi pagave gjithsej	Minleke	381.69	392.09	344.87	88.0	354.70	77.80	92.30	92.30	92.30	102.9	371.00	371.00
3	Fondi sigurimeve shoqërore/shëndetësore	Minleke	64.14	65.48	58.02	88.6	59.23	12.99	15.41	15.41	15.41	102.1	61.96	61.96
4	Punonjës në asistencë	Minleke	0.00	2.00	0.36	18.0	3.60	1.00	1.00	0.80	0.80	1000.0	2.50	2.50
V	Treguesit Financiar													
A/1	Të ardhura nga aktiviteti kryesorë (1+2+3+4+5)	Minleke	961.38	947.60	3065.40	323.5	940.29	183.31	144.16	144.11	468.71	30.7	925.68	924.79
